

# STUDENTI

Gazetë e studentëve të AAB-së, qershor - gusht 2015 , Nr.4, Viti IV

Në AAB u mbajt konferenca shkencore ndërkombëtare për komunikimet dhe mediat, më e madhja në rajon



faqe 4

AAB përfitues i projektit "Erasmus+ International Credit Mobility "

faqe 3

AAB dhe Universiteti Lodz nga Polonia, nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi

faqe 6

Libri më i ri shkencor "Komunikimi në diplomacinë publike", botim i AAB-së

faqe 19

AAB nderoi me Çmimin "Ali Podrimja", shkrimtarin malazez Jevrem Bërković

faqe 19



## AAB fillon vitin e ri akademik 2015/16 edhe me një objekt të ri, prej rreth 18 mijë metrash katrorë

faqe 12



## AAB nderoi ambasadorin holandez me Çmimin "Doctor Honoris Causa"

faqe 2

# AAB nderoi ambasadorin holandez me Çmimin “Doctor Honoris Causa”



i nderuar që ia ndan titullin “Doctor Honoris Causa” Dekanit të Korit Diplomatik të akredituar në vendin tonë, SH. T. Ambasadorin e Mbretërisë së Holandës, z. Robert Bosch, si titulli më i lartë që e jep ky institucion. “Që nga themelimi e deri më sot me titullin “Doctor Honoris Cauza”, i kemi nderuar dy personalitete të shquara: Presidentin e Kroacisë z. Stjepan Mesić, për kontributin dhe përkrahjen e tij të jashtëzakonshme për lirinë dhe pavarësinë e vendit tonë, si dhe presidentin

Bosch ka ardhur nga studentët dhe profesorët e Departamentit të Shkencave Politike, në të cilin fakultet kanë mbajtur ligjërata pothuajse të gjithë ambasadorët në vendin tonë.

Ndërsa profesoresha Venera Lljunji, në rolin e laudatores, e lexoi arsyetimin e ndarjes së Çmimit “Doctor Honoris Causa”. Ajo tha se si rezultat i angazhimit, përkushtimit dhe punës së tij në përfaqësim të denjë të Mbretërisë së Holandës, në përkrahjen ofruar institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovë, në rrugën e saj për zhvillim dhe ndërtim politik, ekonomik e ndërnjerëzor, mbështetur në statutin e Kolegjit AAB, Senati i Kolegjit ka vendosur që titullin “Doctor Honoris Causa” për merita të veçanta në diplomacinë proaktive në Ballkan, t’ia ndajë ambasadorit të Mbretërisë së Holandës, Sh.T. Robert Bosch.

Ambasadori i Mbretërisë së Holandës në Kosovë, Sh.T. Robert Bosch pasi mori çmimin nga rektori Lulzim Tafa, shprehu mirënjohjen e tij, duke thënë se është nder që në profesionin e tij që i jepet një mirënjohje e madhe nga një universitet kaq i madh. “Arsyetimi i lexuar nga profesorët ndoshta është i ekzagjeruar sepse ju e dini se kur i lexoni emrat e njerëzve tjerë ju tho-

ni me vete, pse unë? Por, në të vërtetë unë kam bërë të pamundurën që të promovoj demokracinë, sidomos të drejtat e njeriut për minoritetet dhe gjithashtu shtetin e së drejtës si ambasador i OSBE-së- unë gjithmonë prapa skenës, jo gjithmonë me sukses, edhe këtu si ambasador i Holandës me të ardhur kam vepruar në mënyrë të njëjtë. Gjithashtu ligjvënësve ua kam bërë me dije detyrat e tyre duke ua treguar rrugën e tyre euroatlantike”, tha Bosch.

Ambasadori Bosch duke u nisur nga eksperiencia e tij në Shqipëri e Kosovë, tha se tekstet shkollore, jo vetëm ato të historisë, por të gjitha shkencave shoqërore në Kosovë e Shqipëri duhet të avancohen sipas modelit europiano-perëndimor.

Ambasadori Bosch, në fjalën e tij falënderoi në mënyrë të veçantë presidentin Moisiu dhe ministrin Arben Malaj, që kanë marrë mundimin të vijnë nga Tirana vetëm për këtë ceremoni.

Ambasadori Bosch në fund të fjalimit tha se ky çmim është çmim për të gjithë kolegët e tij të cilët kanë dhënë më të mirën për të punuar për vendet e tyre, duke dëshiruar një të ardhme më të mirë e të ndritshme për Kosovën.

Ambasadorin i Mbretërisë së Holandës në Kosovë, Sh.T. Robert Bosch, është nderuar sot nga Kolegji AAB me titullin “Doctor Honoris Causa” me motivacionin: për përpjekjet e jashtëzakonshme në promovimin e diplomacisë proaktive dhe kontributin unik për demokracinë në Shqipëri dhe në Kosovë.

Në ceremoninë e laurimit morën pjesë ish-presidentët e Shqipërisë Alfred Moisiu e Fatmir Sejdiu, ish-kryeministri Ramush Haradinaj, zv.kryeministri Kujtim Shalla, ministrat Ferid Agani, Edita Tahiri, Hikmete Bajrami, deputetët Flora Brovina, Nenad Rashiq, Emilija Rexhepi, shefi i EULEX-it, Gabriele Meucci, shumica

e ambasadorëve të akredituar në Kosovë, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe profesor dhe studentë. Prof. dr. Lulzim Tafa, rektor i Kolegjit AAB, në praninë e mysafirëve, tha se ndihet

e Republikës së Hondurasit, kurse sot e nderojmë ambasadorin Bosh për modelin e intelektualit dhe diplomatit që përfaqëson”, tha rektori Tafa. Ai shtoi se propozimi për laurimin e ambasadorit



## Impresum

### STUDENTI

Gazetë e studentëve të AAB-së

Botues: BPrAL AAB

Kryeredaktor: Zija Rexhepi

Redaktore përgjegjëse: Naile Demiri

Gazetën e përgatitën studentët e AAB-së

Foto:

Rrahman Drenica dhe Ylli Selmani

Dizajni grafik:

Besfort Mehmeti

e-mail: info@aab-edu.net

## “Ditët e AAB-së, 2015”

# U mbajt edicioni i VIII-të i Manifestimit më të madh universitar në Kosovë, “Ditët e AAB-së, 2015”



Në një ceremoni solemne, në ambientet e institucionit të arsimit të lartë universitar AAB, në Prishtinë, u hap edicioni i VIII-të, i manifestimit më të madh universitar në Kosovë, “Ditët e AAB-së, 2015”.

Hapjen zyrtare të “Ditëve të AAB-së, 2015”, e bëri rektori prof. dr. Lulzim Tafa, i cili foli për historikun e AAB-së, dhe

mundësitë që ofron ky institucion i lartë arsimor. “Më lejoni që të shpall të hapur edicionin e teutë, të manifestimit tradicional më të madh universitar në Kosovë “Ditët e Kolegjit AAB, 2015”, i cili manifestim organizohet në çdo përvjetor të themelimit të institucionit të lartë arsimor të parë në Kosovë nga sektori jopublik.

Tanimë po bëhet një dekadë e gjysmë e punës sonë në fushën edukative shkencore. Në këtë vit akademik AAB-së iu bashkuan edhe 6.000 studentë, 6.000 të rinjë e të reja nga Kosova, rajoni dhe më gjerë, duke i lidhur ëndrrat dhe fatet e tyre me ne”, tha Tafa. Rektori Tafa, shtoi se për një dekadë e gjysmë AAB u bë institucioni arsimor më

i madh dhe më cilësor jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon nga sektori jo publik. “Si rezultat i shtimit të numrit të studentëve për çdo vit, ne jemi duke i zgjeruar vazhdimisht kampuset tona. Përveç objekteve ekzistuese, si në Prishtinë, Ferizaj dhe Gjakovë, nga ky vit akademik ne do të kemi edhe një objekt universitar, punimet në ndërtimin e të cilit po zhvillohen me intensitet të shpejtë, e që do të njihet si AAB-7 apo 7-shi”, tha rektori Lulzim Tafa.

Në kuadër të programit të hapjes së “Ditëve të AAB-së, 2015”, u hap edhe ekspozita kolektive e studentëve të arteve pamore në AAB, kurator i së cilës është prof. Fitim Aliu. Ekspozitën e shpalli të hapur profesori Shyqeri Nimani: “Ekspozita të cilën këtë vit po e prezantojmë, pasurohet edhe edhe me disa seksione të tjera të cilat kanë të bëjnë me përgatitjen e librit, grafikën reklamuese,

multimedia, pastaj ajo që është më e re, këtë vit, për herë të parë paraqiten punimet e degës së “Fashion Design”, pra Dizajnit të Modës, të cilat gjithashtu kanë një nivel të kënaqshëm dhe mund të them se stafi mësimor i këtij fakulteti ka qenë shumë i angazhuar që studentët në këto gjashtë vitet e fundit, pra në këto dy gjenerata të cilat janë të akredituara në Dizajnin Grafik, në tetor do të të fillojmë dhe me studimet master me që besoj se jemi shumë afër që të akreditohejmë”, tha Nimani.

Studentë të Fakultetit të Arkitekturës dhe Arteve të këtij institucioni kanë ekspozuar punime të shumta nga të gjitha gjinitë e arteve pamore: arkitekturë, ilustrim, grafikë, grafikë reklamuese, multimedia, fotografi, pikturë, vizatim, art konceptual etj. Hapja e manifestimit “Ditët e AAB-së, 2015”, është përcjellë edhe me një program artistik me pika të zgjedhura muzikore, interpretuar nga studentët e Fakultetit të Muzikologjisë të AAB-së dhe korit AAB.

Ekspozita do të mbetet e hapur gjatë tërë periudhës sa zgjat manifestimi “Ditët e AAB-së, 2015”, ndërsa gjatë këtij edicioni do të organizohen aktivitete të shumta shkencore, studimore, artistike dhe sportive.



## AAB përfitues i projektit “Erasmus+ International Credit Mobility”

Nga ky vit i ri akademik dhe për disa vite me radhë Kolegji AAB është përfitues i projektit “Erasmus+ International Credit Mobility”, projekt që financohet nga fondet e programit Erasmus për institucionet arsimore të Republikës së Polonisë.

Nga ky projekt, për këtë vit të i ri akademik studentët e Kolegjit AAB, me bursë të plotë mund të vazhdojnë studimet universitare për një semestër në nivelin bachelor dhe Master, në Universitetin e mirënjohur të Lodz në Poloni.

Ky mobilitet për vazhdimin e studimeve në universitetin në fjalë është arritur në sajë të marrëveshjes së bashkëpunimit ndëruniversitar AAB dhe Universiteti i Lodz, në kuadër të implementimit të projektit të fituar për fonde të Komisionit Evropian “Credit mobility” në fushën e mobilitetit të personelit dhe të studentëve.

Ky projekt është realizuar në kuadër të Marrëveshjes Kornizë për bashkëpunim me Universitetin Lodz, e cila përveç shkëmbimit të stafit

akademik dhe të studentëve, parasheh edhe projekte të përbashkëta zhvillimore dhe hulumtuese, seminare dhe takime të tjera për çështje akademike e shkencore, përdorimin e bibliotekave përkatëse për nevojat e studimeve dhe hulumtimeve shkencore, si dhe takime tjera akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dyja vendet.

Universiteti i Lodz me seli në Poloni, është universitet publik, dhe ndër universitetet më të mëdha në vend,

me bashkëpunim intensiv ndërkombëtar me më se 400 partnerë në përmasa botërore, dhe është anëtar

aktiv në projekte të Komisionit Evropian dhe më gjerë.



“Ditët e AAB-së, 2015”

# Në AAB u mbajt konferenca shkencore ndërkombëtare për komunikimet dhe mediat, më e madhja në rajon

Përfundoi punimet Konferenca shkencore ndërkombëtare për komunikimet dhe mediat “Informacioni global dhe kulturat kombëtare”- e cila u organizua nga Fakulteti i Komunikimit Masiv i Kolegjit AAB në bashkëpunim me Departamenti e Gazetarisë dhe Komunikimit të Universiteti (publik) të Tiranës, IPAG Shool të Parisit dhe Ecole Supérieure de Journalisme të Parisit, e cila u mbaj në Kolegjin AAB.

Tashmë tradicionale, kjo konferencë ka zgjuar interesim të jashtëzakonshëm te akademikët, studiuesit dhe profesionistët e kësaj fushe jo vetëm vendi por edhe nga shtetet tjera si: Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Rumania, Franca etj.

Me rastin e hapjes së punimeve të konferencës, rektori i Kolegjit AAB, prof. dr. Lulzim Tafa, tha se duke e kuptuar rolin shkencës në përgjithësi, AAB-ja si institucion i Arsimit të lartë i ka kushtuar rëndësi të veçantë ngritjes së kapaciteteve të brendshme për të avancuar këtë komponentë mjaft të rëndësishme për shoqërinë tonë. Ndërsa Hisen Bytyqi, këshilltar i Ministrisë së Arsimit, i cili foli në emër të ministrit Arsim Bajrami, tha se kjo ngjarje është shumë e rëndësishme për shkak se të arriturat shkencore dhe kontributet e botuara nuk



Rektori i AAB-së, prof. dr. Lulzim Tafa

janë të shpeshta në Kosovë. Dr. Cecile Vrain, drejtoresha për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Ecole Supérieure de Journalisme në Paris, në fjalën e saj falënderoi bashkëorganizatorët e kësaj konference duke thënë se për të është nderë dhe kënaqësi që është pjesëmarrëse dhe bashkëorganizatore e kësaj konference shkencore. “Përmes AAB-së institucioni ynë i ka fut këmbët në Ballkan” u shpreh ajo. Në fjalimin e saj ajo foli për historikun e shkollës së gazetarisë në Paris “Ecole Supérieure

de Journalisme” (ESJ), e cila është edhe shkolla e kësaj lëmie më e vjetra në botë, e themeluar në fund të shekullit të XIX. Dr. Vrain tha se në të ardhmen synojmë të bashkëpunojmë edhe me Kolegjin AAB.

Në hapjen solemne, drejtuesi i Departamentit të Gazetarisë në Universitetin e Tiranës, prof. dr. Artan Fuga, pasi përshëndeti të pranishmit mbajti një fjalim me temën “Modeli i një bashkëpunimi mes dy agjencish Kosovë- Shqipëri”. Ai tha se kjo është konferenca e

dytë shkencore e gazetarisë që e bëjnë bashkë në bashkëpunim me Kolegjin AAB, pas atij që u mbajt në Tiranë, me rastin e 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, në Kuvendin Shqiptar, ku si temë kishin “Histori e medias dhe mediatizimi i historisë. E kemi bërë në bashkëpunim me Kolegjin AAB në Tiranë, në Kuvendin e Shqipërisë, dhe si rezultat doli një punim mbi 600 faqe me shumë arritje për të fiksuar në letër historinë aq sa u zbulua e medias shqiptare”. Prof. Fuga foli edhe bash-

këpunimin ndëruniversitar Kosovë- Shqipëri, në fushën e gazetarisë.

Seancën plenare e moderoi assoc. prof. dr. Bashkim Gjergji, ku me kumtesat tyre u paraqitën një varg studiuesish nga të gjitha vendet pjesëmarrëse.

“Përfundimi është se “hapësirat nënlokale” e lajmit në mediat qytetare digjitale sigurisht ka të bëjë me hapësirat fizike, më përmasat në hapësirë të ngjarjes që raportohet, por mbi të gjitha ajo është universiteti tematik social i individit dhe i gru-



Dr. Cecile Vrain, drejtoresha për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Ecole Supérieure de Journalisme në Paris



Dr. Derek Elzein, IPAG Shool të Parisit



dorë që të nxjerrë përfundimin se duket e mundshme që të themi që gjendja e femrës në media, cilado qofshin ato, po përmirësohet dalëngadalë. Qoftë në raport me numrin e gazetarëve në post me përgjegjësi, ose qoftë me praninë e femrave në media. Ligjvënësi ka qenë i detyruar të intervnoj për ta çuar gjendjen përpara, e cila duket se nuk do të kishte lëvizur”.

Me kumtesat e tyre në seancën plenare u paraqitë; prof. dr. Ibrahim Berisha dr. Derek Elzein, Paris Descartes – Sorbonne, “Mediat perëndimore dhe ndikimi i tyre te të tretët(1) : Rasti i medie në SHBA”, assoc. prof. dr. Mark Marku “Tregu i përbashkët mediatik albanofon mes realitetit dhe utopisë”.

Përveç seancës plenare punimet e konferencës u zhvilluan në disa sesione, ku prezantuan mbi 51 pjesëmarrës - akademikë dhe profesionistë të fushës përkatëse, dhe të moderuar prof. dr. Artan Fuga, prof. dr. Hamit Boriçi, prof. asoc. dr. Ibrahim Berisha dhe dr. Hasan Saliu, prof. asoc. dr. Mark Marku dhe dr. Jonila Godole etj,

Në konferencë u prezantuan edhe një varg punimesh e hulumtimesh të studiuesve të rinj, mësimdhënës universitarë dhe të institucioneve partnere të AAB-së dhe studentë të këtyre profileve. Konferenca e shkencore ndërkombëtare në temën “Informacioni global dhe kulturat kombëtare” është organizuar në kuadër të Manifestimit “Ditët e AAB-së, 2015”.



peve shoqërore jomedios me vazhdimësi fqinjësh fizike, është informacion mbi një ngjarje të ndodhur në hapësirë të kufizuar dhe me sjellje të përditshme të qytetarëve, por me interes të gjerë, si edhe bazohet mbi metafora që evokojnë hapësira të ngushta individuale ose grupe ku lëviz ne jetën e përditshme qytetari” ka thënë prof. dr. Artan Fuga, në kumtesën e tij “Kuptimi i lajmit «nënlokal» në mediat sociale”.

Ndërsa dr. Cecile Vrain, në kumtesën e saj “Vendi i femrës në mediat franceze”, tha se kjo temë në mediat franceze në Francë është një temë aktuale. “Studimi jep



## AAB dhe Universiteti Lodz nga Polonia, nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi

Bashkëpunimi ndërkombëtar si një nga prioritetet e vep-  
rmtarisë së AAB-së, ka sjellë  
edhe një marrëveshje të re uni-  
versitare. Fjala është për mar-  
rëveshjen me Universitetin e  
Lodz, nga Polonia, të cilën në  
emër të institucioneve respek-  
tive e kanë nënshkruar rektori  
i AAB-së, prof. dr. Lulzim Tafa  
dhe prof. dr. Włodzimierz Nyk-  
iel, rektori i Universitetit të Lodz.  
Marrëveshja parasheh bash-  
këpunim ndëruniversitar në të  
gjitha nivelet e studimit, si dhe  
shkëmbimin e stafit akademik  
dhe të studentëve, projekte  
të përbashkëta zhvillimore  
dhe hulumtuese, seminare  
dhe takime të tjera për çështje  
akademike e shkencore, përdorimin e bibliotekave për-  
katëse për nevoja të studimeve  
dhe hulumtimeve shkencore,  
si dhe takime tjera akademike



për çështje të rëndësishme për  
të dy institucionet dhe të dyja  
vendet.

Ky ishte vetëm hapi i parë në  
rrugën e një bashkëpunimi  
të mirëfilltë dhe afatgjatë për  
të ardhmen. Pos kësaj mar-  
rëveshjeje institucionet kanë  
konkurruar edhe me një pro-  
jekt të përbashkët për fonde  
të Komisionit Evropian “Cred-  
itmobility” në fushën e mobi-

litetit të personelit dhe të stu-  
dentëve.

Universiteti i Lodz me seli në  
Poloni, është universitet pub-  
lik, dhe ndër universitet më  
të mëdha në vend, me bash-  
këpunim intensiv ndërkombëtar  
me më se 400 partnerë  
në përmasa botërore, dhe  
është anëtar aktiv në projekte  
të Komisionit Evropian dhe më  
gjërë.

## AAB nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Dokuz Eylöl në Turqi

Bashkëpunimi ndëruniversitar  
në mes Kolegjit AAB dhe uni-  
versiteteve më të njohura në  
Republikën e Turqisë këto ditë  
është thelluar me nënshkrimin  
edhe të një marrëveshjeje të re  
bashkëpunimi me Universite-  
tin Dokuz Eylöl të Izmirit.  
Marrëveshja parasheh bash-  
këpunim ndëruniversitar në  
të gjitha nivelet e studimit,  
si dhe shkëmbimin e stafit

akademik dhe të studentëve,  
projekte të përbashkëta zhvil-  
limore dhe hulumtuese, sem-  
inare dhe takime të tjera për  
çështje akademike e shkencore.  
Po ashtu me këtë marrëvesh-  
je parashihet edhe përdorimi i  
bibliotekave përkatëse për ne-  
voja të studimeve dhe hulumti-  
meve shkencore, si dhe takime  
të tjera akademike për çështje  
të rëndësishme për të dy in-

stitucionet dhe të dyja vendet.  
Universitetin Dokuz Eylöl në  
Turqi, sot renditet lart në ran-  
glistën e universiteteve të klasit  
botërorë, ka numër të madh  
të programeve për studimet që  
ofron, numër të madh të stu-  
dentëve dhe numër të madh  
të stafit akademik, gjithashtu  
është i shquar për bashkëpuni-  
me shkencore ndërkombëtare.

## Një delegacion nga Universiteti Uludag nga Turqia vizitoi AAB



Një delegacion nga Univer-  
siteti Uludag, nga Republika  
e Turqisë, i prirë nga dekan,  
prof. dr. Cenek Aydin, dhe  
një grup studentësh vizituan  
Kolegjin AAB.

Qëllimi i vizitës ishte që të  
shikohen mundësitë për  
fillimin e bashkëpunimit  
ndërinstitucional në mes të  
AAB-së dhe Universitetit Ul-  
udag.

Më konkretisht gjatë  
kësaj vizite janë shqyrtuar  
mundësitë e shkëmbimit të  
studentëve në nivelet bach-  
elor dhe master, si dhe janë  
shqyrtuar edhe programe  
të tjera të veçanta si pro-  
jekte, seminare, transfer i  
teknologjisë, dhe takime të  
tjera akademike për çështje  
të rëndësishme për të dyja  
institucionet dhe të dyja  
vendet.

Prorektori për Çështje  
Mësimore në Kolegjin AAB,  
Shemsedin Vehapi, pasi  
përshëndeti mysafirët dhe i  
falënderoi ata për vizitë, foli  
për historikun e AAB-së, dhe  
mundësitë që ofron ky in-  
stitucion i lartë arsimor. “Për  
një dekadë e gjysmë AAB u  
bë institucioni arsimor më  
i madh dhe më cilësor jo  
vetëm në Kosovë, por edhe  
në rajon nga sektori jo pub-  
lik”, ka thënë prorektori Ve-  
hapi.

Mysafirët ishin shumë të  
kënaqur me të arriturat dhe  
kushtet që ofrohen në AAB,  
sidomos me programet e  
studimit, teknologjinë më  
moderne, infrastrukturën,  
personelin akademik dhe  
me arritjet e studentëve.

## AAB dhe PTK nënshkruajnë marrëveshje mirëkuptimi

Kolegji AAB dhe Postës dhe  
Telekomit të Kosovës Sh.a.  
kanë nënshkruar marrëve-  
shje mirëkuptimi, e cila do  
të mundësojë promovimin,  
përkrahjen dhe ngritjen e  
bashkëpunimit reciprok, në  
funksion të zhvillimit të përg-  
jithshëm edukativ, social dhe  
ekonomik.

Kjo marrëveshje ka për qëllim  
ngritjen e nivelit të bash-  
këpunimit në mes të Uni-  
versiteti AAB dhe Postës dhe  
Telekomit të Kosovës Sh.a., me  
pikësynim përkrahjen e ngritjes

së nivelit edukativ dhe profe-  
sional të të rinjve kosovarë, si  
dhe në krijimin e një ambienti  
më të volitshëm ekonomik.

“Studentët e AAB-se do të kenë  
mundësi që të angazhohen në  
kryerjen e punës praktike në  
PTK, me qëllim të aftësimit të  
tyre profesional, gjenerimit të  
punësimit dhe zvogëlimit të  
papunësisë”, ka thënë drejtori  
Menaxhues i PTK-së, Agron  
Mustafa me rastin e nënsh-  
krimit të marrëveshjes.

Njëherësh, kjo marrëveshje do  
të mundësojë që AAB dhe PTK-

së të shkëmbejnë ekspertët dhe  
përvojat e tyre në fushat e cak-  
tuara ekonomike me qëllim të  
realizimit të qëllimeve të për-  
bashkëta.

Ndërsa nga ana e saj, dekanja  
e Fakultetit Ekonomik në AAB,  
prof. Vjollca Hasani, ka thënë  
se me nënshkrimin e kësaj mar-  
rëveshjeje, AAB dhe PTK pajto-  
hen që të realizojnë projekte të  
përbashkëta ekonomike.

“AAB dhe PTK synojnë real-  
izimin e projekteve që kanë të  
bëjnë me përmirësimin e am-  
bientit ekonomik dhe social



në Kosovë, hartimin e anal-  
izave të kërkimit të tregut dhe  
në rastet kur bashkëpunimi  
është i mundshëm të paraqes-  
in ofertën e përbashkët dhe  
të këmbëjnë informatat e do-  
mosdoshme për implemen-  
timin e projekteve”, ka theksuar  
prof. Vjollca Hasani.

PTK do të vazhdojë të zgjerojë  
bashkëpunimin dhe përkrah-  
jen, me qëllim të aftësimit pro-  
fesional të të rinjve dhe krijimit  
të një ambienti më të volitshëm  
ekonomik për qytetarët e ven-  
dit tonë. Marrëveshja në fjalë  
është nënshkruar në ambientet  
e PTK-së.

“Ditët e AAB-së, 2015”

## Konferencë Shkencore e studiuesve të rinj të Fakultetit të Shkencave Sociale



Në kuadër të Manifestimit “Ditët e AAB-së, 2015”, Fakulteti i Shkencave Sociale në AAB, mbajti konferencën studentore në temën “Zhvillimi dhe edukimi në fëmijëri të hershme”, ku studentët e përzgjedhur nga të gjitha kampuset prezantuan hulumtimet e tyre shkencore të cilat i punuan gjatë semestrit veror. Të pranishëm përveç studentëve ishin edhe stafi akademik i këtij fakulteti.

Në hapje të kësaj konference studentore udhëheqësja e këtij fakulteti, prof. Elizabeta Musliu, prorektori, prof. dr. Shemsedin Vehapi dhe mësime-dhënësi prof. dr. DonikSallova, theksuan rëndësinë e hulumtimeve shkencore në degën e edukimit parashkollor, që mund të përdoren si bazë për të bërë punë të bazuar në gjetjet hulumtuese.

Përveç prezantimeve, të pranishmit patën rastin të marrin

pjesë edhe në ekspozitën e lodrave dhe instrumenteve muzikore të punuara nga studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale, të cilat do të donohen për fëmijët e SOS fshatit.

Nga 15 punimet e përzgjedhura të cilat u prezantuan në punimet e kësaj konference, u shpërblyen tri më të mirat të vlerësuara nga komisioni profesional. Me vendin e parë u shpërblye Behare Pllana, studente e vitit të tretë, për hulumtimin e saj: “Ndikimi i edukimit parashkollor në zhvillimin social të fëmijëve”.

Qëllimi i këtij organizimi ishte të promovojë rëndësinë e hulumtimeve shkencore në fushën e edukimit, si dhe të ndihmojë studentët në zhvillimin e shkathtësive hulumtuese si dhe në prezantim.

Edhe studentët u shprehën shumë të kënaqur me organizimin.

## Tryezë me temën “Perspektiva zhvillimore e Komunës së Gjakovës”



Në kuadër të Manifestimit “Ditët e AAB-së, 2015”, Fakulteti Ekonomik, dega në Gjakovë, mbajti një tryezë në temën “Perspektiva zhvillimore e Komunës së Gjakovës”, ku të pranishëm ishin përfaqësues të institucioneve qendrore e lokale të Republikës së Kosovës, përfaqësues të organizmave biznesorë dhe kompanive të suksesshme, profesorë dhe studentë të AAB-së, mysafirë dhe të interesuar të tjerë.

“Kosova, po ashtu edhe Gjakova karakterizohet me papunësi të madhe, prandaj të gjithë pyesim se çka po bën Qeveria në këtë aspekt. Mirëpo unë do ta

shtroja pyetjen e kundërt, çka po bëjmë ne për ta ndihmuar Qeverinë në këtë aspekt. Zgjidhja për krizën është vetëm iniciativa private, e cila nuk do të thotë të jetë inovacion mirëpo shfrytëzimi i modeleve më të mira nga bota”, ka thënë drejtori degës së AAB-së në Gjakovë, Jusuf Çarkaxhija, kurse ministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Blerand Stavileci, ka shprehur gatishmërinë të ndihmojë Gjakovën nga institucioni të cilën e drejton, ndërsa, kryetarja e Komunës së Gjakovës bëri një prezantim për gjendjen ekonomike aktuale në Komunën e

Gjakovës si dhe foli mbi sfidat me të cilat aktualisht ballafaqohet kjo komunë, që nga koha e represionit ndaj shqiptarëve si dhe në periudhën e pasluftës në Kosovë. Po ashtu diskutuan Silvana Domi, drejtoreshë e Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Gjakovës, ish-ministri Bernard Nikaj, Afrim Batalli nga sektori prodhues dhe Fatos Stavileci nga sektori i teknologjisë informative etj. Në debat morën pjesë edhe shumë studentë të Fakultetit Ekonomik të cilët diskutuan dhe dhanë vlerësime të ndryshme, mbi temën e debatuar.

## Studenti i AAB-së, Herolind Bytyqi, zhvillon aplikacion të veçantë për banka dhe kompani

“Një aplikacion i ngjashëm është zhvilluar për njërin nga bankat komerciale në Kosovë, por veçantia e këtij aplikacioni është menaxhimi i tejet i lehtë i pikave në hartë, përmes një CMS-je të thjeshtë, pa qenë e domosdoshme që të kemi njohuri në programim”, ka thënë Herolind Bytyqi.

Ai në saje të bashkëpunimit student-profesor, si student i vitit të I në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike të AAB-së, në lëndën “Aplikacionet, shërbimet dhe teknologjitë e bazuara

në lokacione”, te prof. Ermir Rogova, ka arrit të zhvillojë aplikacionin në fjalë, i cili aplikacion është i ndërtuar në JAVA / SQL/ PHP/ HTML/ CSS, dhe është i ndërtuar për platformën Android.

Herolindi thotë se aplikacioni mund të përdoret në të gjitha pajisjet që përkrahen nga sistemi operativ Android si: smartphone, tablete etj.

Ky aplikacion ka disa funksione: Gjetjen e lokacionit aktual të përdoruesit, shfaqjen e ATM-ve dhe ATM-së më të afërt në hartë

të bankës, në momentin që klikohet një pikë ATM-je atëherë aplikacioni të shfaq rrugët e mundshme deri te ATM-ja e zgjedhur si dhe kohën dhe distancën.

“Aplikacioni mund t’ju hyjë në funksion një numri të madh të kompanive që operojnë në territorin e Kosovës. Si shembull, mund të merren të gjitha bankat, të cilat me këtë aplikacion klientëve të tyre mund t’ju ofrojnë detaje tejet të hollësishme për degët e tyre si dhe ATM-ve të tyre me ç’rast aplik-

acioni mundëson edhe treguesin e rrugës dhe kohën deri tek ATM-ja më e afërt. Gjithashtu, aplikacioni mund të përdoret edhe nga kompanitë që ofrojnë derivate që pjesëmarrësve të komunikacionit t’ju mundësojë gjetjen e pikave shitëse”, ka thënë Herolindi.

Ai shton se në përgjithësi aplikacioni është i nevojshëm për çdo kompani që e ka biznesin e shtrirë në tërë Kosovën.



“Ditët e AAB-së, 2015”

# Fëmijët e Qendrës “Down Syndrome Kosova” zhvilluan aktivitete të përbashkëta me studentët e AAB-së



Në kuadër të Manifestimit “Ditët e AAB-së, 2015”, studentët e Kolegjit AAB në bashkëpunim me qendrën “Down Syndrome Kosova”, kanë organizuar aktivitetin humanitar për fëmijët me

sindromin Down, anëtarë të kësaj qendre. Gjatë këtij aktiviteti, fëmijët e “Down Syndrome Kosova”, vizituan kampusin e AAB-së në Prishtinë, ndërsa janë organizuar lojëra për fëmijë

ijë për qëllime edukative, shpërndaje e dhuratave për ta, etj. Në fund të aktivitetit organizatorët së bashku me fëmijët kanë ngrënë drekë së bashku dhe kanë biseduar për çështje të natyrave edukative.

Përveç organizatorëve, të gjithë fëmijët u ndanë të kënaqur në shoqërimin e studentëve dhe krijuan një afërsi të jashtëzakonshme me ta.

Studentët e AAB-së u shprehën të gatshëm që tash e tutje t'i ndihmojnë kësaj qendre në formë vullnetare në çfarëdo aktiviteti që mund t'i angazhojë Down Syndrome Kosova.



## Aksion për dhurimin vullnetar të gjakut në ambientet e AAB-së

Studentët dhe stafi i AAB-së, në kuadër të aksionit tashmë tradicional për këtë institucion, janë solidarizuar në aktivitetin për dhurimin vullnetar të gjakut, aksion ky që po zhvillohet në kuadër të Manifestimit “Ditët e AAB-së, 2015”,

“Nga dhurimi i gjakut përfiton jo vetëm marrësi, por edhe vetë dhuruesi. Është vetëm një freskim i rruazave të gjakut,

mirëpo për pacientin është jetë, sepse ai që dhuron gjak mund të shpëtojë jetën e dikujt në nevojë”, kanë thënë Leonora Berisha dhe Ajni Shabani, studentë, të cilët posa dhuruan gjak. Aktiviteti në fjalë - dhurimi i gjakut do të vazhdojë edhe dy ditë me radhë në ambientet e objektit II, të AAB-së në Prishtinë.



## Tryezë me temën “Delikuenca e të miturve”



Në kuadër të Manifestimit “Ditët e AAB-së, 2015”, dhe në kuadër të realizimit të projektit hulumtues “Delikuenca e të miturve” të Fakultetit të Juridikut në Kolegjin AAB, dega në Gjakovë, u mbajt debati në temën “Delikuenca e të miturve”, ku të pranishëm ishin qytetarë e përfaqësues të institucioneve lokale të Komunës së Gjakovës, profesorë dhe studentë të AAB-së, etj.

Në këtë tryezë panelistë ishin: Ali Selimaj, prokuror i Shtetit, Prokuroria Gjakovë; Tush Markaj, kapiten, hetuesia regjionale Gjakovë; prof. Fatmir Çollakaj, prodekan i Fakulteti Juridik. AAB dhe Mensut Ademi, udhëheqës

i Qendrës Hulumtuese, Fakulteti Juridik, AAB, ndërsa tryezën e moderoi Ganimet Ismajli.

Diskutimi ishte i frytshëm dhe u prekën problemet me të cilat përballen të rinjtë dhe shkaqet e delikuençës në Komunën e Gjakovës.

Prokurori Selimaj paraqiti gjendjen rreth kësaj problematike nga prizmi i punës së Prokurorisë dhe rëndësinë e këtij institucioni në funksionimin e shtetit ligjor. Ndërsa, kapiten Tush Markaj poashtu nga aspekti i punës së Policisë paraqiti të arriturat dhe sfidat e policisë me dukurinë e delikuençës dhe shkaqet e manifestimit të saj.

Profesor Çollakaj shkoqiti dhe elaboroi rolin e delikuençës, ku kryesit e veprave penale nga kategoria e të miturve i sheh si viktimat të rrethanave dhe proceseve të imponuara gjatë të cilave faza në proces, familja dhe institucionet formale nuk i kanë kryer si duhet obligimet e tyre ndaj të miturve.

Në fund të debatit u hap një diskutim i gjerë, ku edhe mësimdhënësi Mensut Ademi prezantoi ecurinë e hulumtimit, mundësinë e anëtarësimit të studentëve hulumtues të Fakultetit Juridik AAB në shoqatat hulumtuese regjionale dhe ndërkombëtare.

“Ditët e AAB-së, 2015”

# Tryezë me temën “Trendet aktuale ekonomike në Kosovë”



Në kuadër të Manifestimit “Ditët e AAB-së, 2015”, Fakulteti Ekonomik i AAB, mbajti një tryezë në temën “Trendet aktuale ekonomike në Kosovë”, ku të pranishëm ishin përfaqësues të institucioneve qendrore e lokale të Republikës së Kosovës, përfaqësues të organizmave biznesor dhe kompanive të suksesshme, profesorë dhe studentë të AAB-së, mysafirë dhe të interesuar të tjerë, të cilët e përcollën me interesim debatin.

Fillimisht, rektori i AAB-së, prof. dr. Lulzim Tafa, pasi përshëndeti mysafirët dhe i falënderoi ata për pjesëmarrje në debat, foli për historikun e AAB-së, dhe mundësitë që ofron ky institucion i lartë arsimor, dhe tha se tema e cila po diskutohet, është një temë e rëndësishme së veçantë, por edhe mjaft delikate për faktin se pikërisht këta trendë nuk janë aspak inkurajues për vendin tonë. Ndërsa dekanja e Fakultetit Ekonomik, dr. Vjoll-

ca Hasani, pasi hapi debatin dhe falënderoi të pranishmit mbi të gjitha i njoftoi se AAB-ja është një institucion që ka traditë të gjatë në organizimin e debateve nga fusha të ndryshme, me interes për studentët dhe për opinionin e gjerë. Zëvendësiministri i Financave z. Agim Krasniqi, foli për rolin dhe punën që po bëhet në këtë ministri: “Ne vlerësojmë se viti 2015 është një vit stabilizues të cilin e përcjell një rritje ekonomike prej 3.8%, dhe janë katër



indikatorë që ndikojnë në këtë rritje ekonomike, si; çështja e konsumit, diaspora, përmirësimi i eksportit dhe sektori i bujqësisë dhe sektorë të tjerë. Në tre vjetët e ardhshëm do të kemi një rritje mesatare prej rreth 4.4 %, por kjo rritje për Republikën e Kosovës nuk është e mjaftueshme, por presim investime më të mëdha si në energji, rastin me Brezivoicën, ndërsa investimi që e kemi rritë në bujqësi, presim të ketë rezultate”. Kurse Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës së Prishtinës, tha se sot ne jemi vendi me papunësinë më të madhe në Evropë, dhe tash e tutje ideja është prej nga po vjen rritja ekonomike, kujt t’i drejtohem për ven-

det e reja të punës, qysh do të rritemi në ekonomiksht. Nga ana tjetër deputeti dhe anëtar i Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Besim Beqaj, foli për zhvillimet e fundit në Kosovë dhe rreth vendimeve që janë duke u zbatuar tani, diskutoi Robert Wright- drejtor i Bordit të Asociacionit të Bankave të Kosovës, i cili u fokusua nëqëndrueshmërinë e sistemit bankar si sektori më i rëndësishëm në vendet në zhvillim e sipër. Në debat morën pjesë edhe shumë studentë të Fakultetit Ekonomik të cilët diskutuan dhe dhanë vlerësime të ndryshme, mbi temën e debatuar.

## Studentët e AAB-së, Ngadhnjimi dhe Dreni i vazhdojnë studimet master në SHBA

Ngadhnjim Halilaj dhe Dren Puka, të cilët studimet bachelor i kanë përfunduar për Menaxhment dhe Informatikë në Fakultetin Ekonomik të AAB-së, studimet master nga ky vit i ri akademik do t’i fillojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, falë bursës së plotë të fituar nga organizata World-Learning në bashkëpunim me USAID-in dhe Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në programin Transformational Leadership Program- Scholarships and Partnerships (TLP- SP).

Ngadhnjimit i është caktuar që këto studime t’i vazhdojë në Northern Illinois University, në Illinois të Çikagos, në Fakultetin e Biznesit në drejtimin Menaxhment dhe Sistemet Informatike. Ngadhnjimi shprehet tejet i kënaqur që i është realizuar ëndrra e kamotshme për vazhdimin e një palë studimeve

jashtë vendit. “Për vazhdimin e studimeve jashtë Kosovës ka qenë dëshirë që prej mbarimit të studimeve Bachelor, kështu që kjo mundësi që më është ofruar në njëfarë mënyre mund ta quaj edhe si realizim i njëres prej dëshirave dhe qëllimeve të mia në jetë”, ka thënë Ngadhnjimi.

Si Ngadhnjimi ashtu edhe Dreni në një bisedë për gazetën “STUDENTI”, rrëfejnë për përvojat e studimeve në AAB, të cilët shprehen tejet të kënaqur që kanë qenë pjesë e këtij institucioni më të madh

jopublik në vend dhe rajon, për njohurit e fituara, po ashtu që të dy shprehen se qëllimet e tyre pas përfundimit të studimeve në SHBA janë të kthehen në Kosovë dhe të japin kontributin maksimal dhe profesionalisht për zhvillimin e vendit.

Ngadhnjimi pas diplomimit të studimeve në AAB është punësuar dhe aktualisht është në organizatën jo-qeveritare Demokraci për Zhvillim (D4D), kurse Dreni punon në Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Zyrtar i programit për zhvillim të shoqërisë civile.



## Studentët e Fakultetit Juridik të degës së Ferizajt, vizituan Qendrën Korrektuese në Lipjan

Studentët e Fakultetit Juridik të Kolegjit AAB, dega në Ferizaj, në kuadër të lëndës “Penologjia”, të shoqëruar nga mësime-dhënësit Artan Fejzullahu dhe Mensut Ademit, realizuan një

vizitë studimore në Qendrën Korrektuese në Lipjan.

Studentët u njoftuan së afërmi me organizmin e institucionit korrektuese, trajtimin dhe riintegrimin e të dënuarve.



“Ditët e AAB-së, 2015”

# Debat në temën “Migrimi ilegal i qytetarëve të rajonit të Ferizajt”



Në kuadër të Manifestimit “Ditët e AAB-së, 2015”, dhe në kuadër të realizimit të projektit hulumtues “Migrimi ilegal” të Fakultetit të Administratës Publike në Kolegjin AAB, dega në Ferizaj, u mbajt debati në temën “Migrimi ilegal i qytetarëve të rajonit të Ferizajt”, ku të pranishëm ishin qytetarë e përfaqësues të institucioneve lokale të Komunës së Ferizajt, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të Kryqit të Kuq, përfaqësues të Zyrës për Komunitete në Komunën e Ferizajt, profesorë dhe studentë të AAB-së etj. Fillimisht dekan i Fakultetit të Administratës Publike, Petrit Bushi, falënderoi të ftuarit për praninë e tyre

dhe i njoftoi ata për traditën e AAB-së në organizimin e debateve nga fusha të ndryshme me interes për studentët dhe opinionin. Poashtu, vlerësoi pjesëmarrjen e të ftuarve dhe të studentëve, si garanci për implementimin e projektit në fjalë.

Ndërsa, mësimdhënësi Avni Alidemaj, dha informatat rreth temës së debatit dhe njoftoi për nismën e studentëve të Fakultetit të Administratës Publike në projektin hulumtues, i cili do të finalizohet në muajin shtator. “Komuna e Ferizajt është bërë epiqendra e migrimit, prandaj projektin e kemi filluar pikërisht këtu”, tha z. Alidemaj. Kurse ana tjetër

drejtor i degës së AAB-së në Ferizaj, Medain Hashani, paraqiti statistikën e papunësisë në Kosovë dhe shpjegoi faktorët ekonomik që kanë ndikuar në migrimin e qytetarëve ferizajas.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Ferizajt, Faruk Guri, tha se migrimi ilegal si dukuri na shqetëson të gjithëve, ndërsa faktorët që ndikojnë në lëvizjet e popullatës ai përmendi natalitetin, arsyet politike dhe ekonomike, jozhvillueshmërinë e rajonit, territorin e vogël të Ferizajt në raport me banorët, si vendi pamjaftueshëm për mbijetesë, si dhe fajësoi BE-në, e cila me mosliberalizimin e vizave po i jep shans ikjes.

Profesori në Kolegjin AAB, Dashnim Ismajli dha një statistikë perëndimore se janë mbi 200.000 emigrantë të regjistruar kohëve të fundit. Faktorë për fenomenin e migrimit tha se janë izolimi dhe getoizimi i shqiptarëve, qasja diskriminuese e Evropës ndaj shqiptarëve, mosbesimi i qytetarëve ndaj qeverisë, mashtrimi nga grupet kriminale eksterne dhe interne, ngërçi politik dhe mos arritja e formimit të qeverisë pas zgjedhjeve të fundit, që ka shkaktuar humbjen e shpresës dhe një revoltë të brendshme, jo me protestë, por me ikje nga vendi.

Kurse, Arta Tahiri, asambleiste në Kuvendin Komunal të Ferizajt, foli rreth migrimit që nga pushtimet osmane e deri tek hovi i fundit i migrimit për të cilin ajo mendon se ka si nxitës zhvillimet politike në vend. Përfaqësuesi i Kryqit të Kuq të Kosovës, dega në Viti, Zaim Hajrizi, njoftoi për rolin e tyre në procesin e riatdhesisë të kosovarëve, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, të cilët ndihmojnë familjet e kthyer në rrugë zyrtare, sipas kriterëve të përcaktuara nga Qendra për Punë So-

cialë. Fuat Behluli nga Kryqi i Kuq i Kosovës, dega në Ferizaj, njoftoi se në një projekt të përbashkët me Kryqin e Kuq të Suedisë, i cili ka filluar në vitin 2008 dhe ka përfunduar këtë vit, janë përfshirë 97 familje përfituese nga ky projekt.

Qytetarja ferizajase, Vjollca Aliu, duke vlerësuar punën hulumtuese të studentëve të Fakultetit të Administratës Publike të Kolegjit AAB, e të cilët në fund të projektit hulumtues do të dalin me një diagnostikim më të saktë për këtë dukuri, tha se faktor me ndikim për migrim të familjeve ajo sheh femrat, të cilat joshen nga të afërmet e tyre që jetojnë në shtetet evropiane dhe rënien e remitancave.

Përfaqësuesja e Zyrës për Komunitete në Komunën e Ferizajt, Xhevahire Dervishi-Rexhepi, z. Kenan Gashi nga OJQ “AVONET”, z. Albion Sherifi nga Forumi politik i të rinjve, dhanë mendimet kryesisht lidhur me debatin në fjalë.

Në debat morën pjesë edhe shumë studentë të Fakultetit të Administratës Publike të cilët diskutuan dhe dhanë vlerësime të ndryshme, mbi temën e debatuar.

## Stafi i AAB-së, mori pjesë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Rezistenca dhe Identiteti” në Gjermani

Gjatë muajit qershor në Tuzing të Gjermanisë zhvilloi punimet Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Rezistenca dhe Identiteti”, organizuar nga Akademia për Arsim, Edukim dhe Politikë, Universiteti Ludwig-Maximilian i Mynichut, Universiteti i Bremenit, dhe Instituti Shkencor për Evropën Lindore dhe Jug-Lindore në Gjermani, dhe e përkrahur nga Ministria e Arsimit të Gjermanisë.

Në këtë konferencë mori pjesë

edhe profesori i AAB-së, prof. dr. Dashnim Ismajli, i cili përveç prezantimit të temës shkencore “Shtetndërtimi dhe demokratizimi i Kosovës 2000 - 2012”, ka prezantuar edhe rreth sektorit të edukimit dhe arsimit në Kosovë, me theks të veçantë ka prezantuar AAB-në, nga fillimi i punës së saj e deri në ditët e sotshme. Ai ka thënë se AAB-ja është një institucion universitar bashkëkohor, një shembull për cilësi dhe shërbimet që ofron, si konkurrent serioz në fushën e

arsimit dhe shkencës edhe për vendet rajonale.

Në temën e tij shkencore “Shtetndërtimi dhe demokratizimi i Kosovës 2000 - 2012”, z. Ismajli ka paraqitur faktorët eksterne dhe internë, si dhe bashkëpunimin e tyre në shtetndërtim, sfidat që po kalon shoqëria e pas konfliktit në Kosovë, si dhe zhvillimin dhe perspektivën e vendit duke pretenduar integrimin në familjen e shteteve perëndimore.

## Vizitë në çerdhen dhe kopshtin e fëmijëve “Ardhmëria jonë”

Në kuadër të realizimit të plan-programit për vitin akademik 2014/15, studentet e Fakultetit të Shkencave Sociale- Përkujdesja dhe Mirëqenia e Fëmijëve të Kolegjit AAB, kanë realizuar një vizitë studimore në çerdhen dhe kopshtin e fëmijëve “Ardhmëria jonë” në Ferizaj.

Nga personeli i çerdes studentet u informuan për organizimin e lojërave dhe lodrat që përdoren në këtë institucion. Studentet me këtë rastdemonstruan disa

nga lojërat, bashkë me fëmijët e kopshtit dhe u dhuruan fëmijëve nga një lodër të punuar vetë në këtë semestër.



“Ditët e AAB-së, 2015”

## Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike prezantuan suksesshëm projektet e tyre

Në kuadër të Manifestimit “Ditët e AAB-së, 2015”, studentët e nivelit bachelor të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike si Shkëlqim Miftari, Alban Lahu dhe Bujar Prebreza, prezantuan projektet e tyre, të cilat i kanë punuar gjatë semestrit veror.

“Kemi punuar me një angazhim dhe vullnet të madh deri në realizimin e këtyre projekteve. Duke e pasë parasysh që ne jemi në vitin

e parë të studimeve, besojmë në prezantimet e ardhshme do të jemi edhe më të përgatitur, dhe do të punojmë bashkërisht me kolegët e fakultetit”, ka thënë student Shkëlqim Miftari. Aishton se AAB-ja ju ofron ambient dhe kushte të mira për mësim, për realizimin e projekteve e të aktiviteteve të tjera në interes të të bërit shkencë e hulumtime.

Pjesëmarrës në prezantimin e këtyre projekteve ishin

maturantët e shkollave të mesme të Kosovës, të cilët u njoftuan me të gjitha risitë, mënyrat e studimit dhe praktikën e bëra në kuadër të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike. Shumë nga ta, duke i parë kushtet dhe mundësitë që ofron AAB për studime në fushën e Shkencave Kompjuterike, shprehën dëshirën që në të ardhmen të bëhen pjesë e këtyre studimeve.

Punimet të cilat u prezantuan ishin:

- Projektet me pllakat Arduino:

“Lexuesi i mendjes” në të cilin pllaka Arduino programohet për të gjetur se cilin numër e mendon shfrytëzuesi dhe ia qëllon me sukses.

“Piano” ku vendosen butona në pllakën Arduino, të cilat prodhojnë tinguj si piano.

“Motion figura”, në të cilën simulohet rritja e lules nën shpejtësinë e lëvizjes së robotit.



“Matësi i temperaturës” ku senzori i montuar në pllakën Arduino mat temperaturën e shfrytëzuesit.

- Projektet me robotët NAO:

Prezantim informativ rreth Kolegjit AAB;

Prezantim rreth dhurimit vullnetar të gjakut, që u realizua ditë më parë në AAB;

Vallëzimii robotit NAO nën melodinë e caktuar;

Interaksion me shfrytëzuesit përmes kamerave dhe sensorëve të tij.

- Vinçi i komanduar në largësi me telekomandë:

Projektet e bëra nga studentët, në tri vitet e studimit si uebfaqe, lojëra, aplikacione të shitjeve e kështu me radhë, të prezantuara në monitor special ku mund t'i shohin maturantët.

Projektet janë punuar nën mentorimin e dekanit Ermir Rogova, prodekanës Blerta Prevalla dhe asistentëve: Fatime Gashi e Krenar Këpuska.



## U shpallën fituesit e garës studentore të Fakultetit Juridik



Në kuadër të Manifestimit “Ditët e AAB-së, 2015”, Fakulteti Juridik organizoi aktivitetin “Prezantimi i punimeve seminarike”, në të cilën studentët e nivelit bachelor nga Kampusi i Prishtinës dhe Gjakovës të Kolegjit AAB-së, konkurruan dhe prezantuan punimet e tyre hulumtuese-shkencore në formë të seminarëve.

Punimet u prezantuan para komisionit dhe stafit akademik si: prodekanit Fatmir

Qollakaj dhe Artan Fejzullahu, Granit Curri dhe Mensut Ademi.

“Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale, me theks të veçantë paraburgimi”, u vlerësua prezantimi më i mirë, i prezantuar nga studentët Egzon Doli, Qëndresa Xharra dhe Kristina Gjini, nga kampusi i Gjakovës.

“Gjykimet e krimeve të luftës në Kosovë” u vlerësua tema

më e mirë e prezantuar nga studentët Kushtrim Seferaj, Egzon Pajaziti dhe Visar Perlaska, po ashtu nga Gjakova.

“Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare”, u vlerësua për metodologjinë më të mirë, të prezantuar nga studentët Arjanit Godeni, Marjana Nikolla dhe Marijeta Nikolla, studentë në degën e Gjakovës, kurse tema “Terrorizmi dhe IRA (Armata Republikane Irlandeze)” u vlerësua punimi më i mirë, i prezantuar nga studentët Eas Hida dhe Albana Shehu, nga kampusi i Prishtinës.

Prodekan Çollakaj tha se përveç tjerash studentët vetëm sa kanë përvetësuar edhe më shumë metodologjinë për hulumtimin, ngritjen profesionale dhe ngritjen e besimit në prezantimet dhe punimet shkencore.

## Mirënjohje për tre vendet e para në garën e matematikës

Në kuadër të Manifestimit “Ditët e AAB-së, 2015”, Fakulteti Ekonomik në AAB, mbajti garë nga lënda e Matematikës, për studentët e nivelit bachelor, të udhëhequr nga mësimdhënësit e tyre prof. Lulëzim Bytyqi dhe as. Merita Shabani.

Vendi i parë i takoi studentit Bunjamin Huseini, i dyti Dardan Pasjaqes dhe i treti,

Shaban Gashit.

Fituesit e tre vendeve të para u shpërblyen me mirënjohje, të cilat i ndau dekanja e Fakultetit Ekonomik, Dr. Vjollca Hasani.

Qëllimi i kësaj gare ishte të promovojë rëndësinë e lëndëve ekzakte, si dhe të ndihmojë studentët në zhvillimin e shkathtësive garuese.



# AAB fillon vitin e ri akademik 2015/16 edhe me një objekt të ri, prej rreth 18 mijë metrash katrorë



Viti i ri akademik 2015/16 në Kolegjin AAB do të fillojë me inaugurimin edhe të një objekti të ri universitar, duke bërë këtë institucion investuesin më të madh në sektorin e Arsimit të Lartë në vend.

Me rreth 18 mijë metra katrorë sipërfaqe, objekti i ri në kampusin e Prishtinës, padyshim është një nga objektet më të mëdha të arsimit universitar jo vetëm në vend por edhe më gjerë. Kjo ndërtesë gjigante ofron kushte të jashtëzakonshme për studime, të cilat padyshim përmbushin kriteret e standardeve evropiane të studimeve.

Objekti i ri, është i dizajnuar që të përmbushë nevojat dhe kërkesat për zhvillimin e procesit mësimor, hulumtues e kreativ në disa blloqe, si:

Hapësirat për shërbimet administrative,  
Hapësirat për ligjërata (amfiteatro, salla e kabinete),  
Hapësirat sportive (sallë për lojëra sportive, sallë fitnesi, sallë gjimnastike, etj.), si dhe Qendra Kulturore artistike – një hapësirë e jashtëzakonshme brenda së cilës do të operojë teatri, kino, skena e baletit dhe e veprimtarive të ndryshme artistike.

Të veçantë këtë godinë të re e bën edhe oborri i brendshëm, i konstruktuar brenda objektit, me një sipërfaqe

prej 3.000 metrash katrorë.


Gjithashtu, objekti i ri ka edhe laboratorë, kabinete për profesorë, kabinete për konsulta, bibliotekën me sallë të leximit, sallën e konferencave, hapësirën arkivore, amfiteatro, dhoma të mirëmbajtjes së IT, hapësira të shumta sociale dhe ndihmëse, si dhe ashensorë dhe shkallë lëvizëse.

Driton Tefiku, arkitekti i objektit, thotë se “Madhështia e objektit është se ky mund të krahasohet me kriteret, kushtet dhe hapësirat menaxhuese të universiteteve të njohura botërore, çka do të thotë se objekti i ri ofron komoditet të lartë”.

Objekti i ri i AAB-së, është një kryevepër e inxhinierisë moderne, si për nga aspekti vizual ashtu edhe për nga investimi në materialin ndërtimor. Kjo ndërtesë e re e kampusit të Prishtinës, paraqet një realizim ndërtimor me stil dhe dizajn unik e të avancuar.

Do përmendur se Kolegji AAB dita-ditës po shndërrohet në një qendër të rëndësishme rajonale. Punimet në objektin e ri, janë në fazën përfundimtare.

Studentët e AAB-së, por edhe kandidatët e rinj që do të regjistrohen në të ardhmen, padyshim që duhet të ndihen me fat për mundësinë që do të ofrohet nga AAB duke filluar nga viti i ri akademik 2015/16.



## “Ditët e AAB-së, 2015”

# Kuçi: Mbrojta e fëmijëve është investim edhe për të ardhmen tonë

Në kuadër të Manifestimit “Ditët e AAB-së, 2015”, dhe me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, Fakulteti Juridik i AAB-së, mbajti tryezë në temën “Pozita e fëmijëve në shoqëri, të drejtat e tyre dhe format e ndryshme të abuzimit”, ku të pranishëm ishin përfaqësues të institucioneve qendrore të Republikës së Kosovës, profesorë dhe studentë të AAB-së, mysafirë dhe të interesuar të tjerë.

Fillimisht, rektori i AAB-së, prof. dr. Lulzim Tafa, pasi hapi debatin dhe përshëndeti mysafirët dhe i falënderoi ata për pjesëmarrje në debat, foli për Manifestimin “Ditët e AAB-së, 2015”, historikun e AAB-së, dhe mundësitë që ofron ky institucion i lartë arsimor. Ndërsa, dekani i Fakultetit Juridik, prof. dr. Muhamet Kelmendi, pasi falënderoi të pranishmit mbi të gjitha i njoftoi se AAB-ja është një institucion që ka traditë të gjatë në organizimin e debateve nga fusha të ndryshme, me interes për studentët dhe për opinionin e gjerë.

Hajredin Kuqi, ministër i Drejtësisë në Qeverinë e Kosovës, tha se angazhimi për të drejtat e fëmijëve nuk duhet të jetë vetëm nga institucionet, por duhet të nisë



nga familja, rrethi, shkollimi, etj. “Faktorët që ndikojnë; një ambient që respektimi i të drejtave të fëmijëve të jetë i përshtatshëm- e para ta kemi ambientin ku fëmijët të trajtohen si pjesë e ardhmërisë së shoqërisë, dhe kjo nënkupton që më shumë të rregullojmë ambientin dhe qasjen ndaj fëmijëve; e dyta të gjithë të kujdesshëm, në parandalimin e veprimeve delikuede, dhe se si familjet duhet të ndihmojë fëmijët për t’i mbrojtur nga të gjitha dukuritë negative, dhe ta integrojnë në shoqëri. Mbrojta e fëmijëve është investim edhe për të ardhmen tonë”, tha ministri Kuqi.

Z. Behxhet Shala, nga KMDLJN, tha se të drejtat e fëmijëve janë të drejta universale, dhe se ne kemi ligje të mrekullueshme, por situata është krejtësisht ndryshe.

Fëmijët kanë të drejtë për një shkollim cilësor që nga çerdhja e deri te shkollimi universitar, kanë të drejtë për një shëndetësi më të mirë, sepse kanë të drejtë ta kenë një perspektivë më të mirë, por kushtet aktuale në Kosovë nuk garantojnë perspektivë siç ju garantohej fëmijëve të vendeve të Bashkimit Evropian. Shala tha po ta kishim një situatë ekonomike më të mirë, po mos ta kishim këtë varfëri të skajshme, atëherë nuk do të kishte nevojë që një fëmijë të dalë dhe të punojë, ndërkohë që kjo është e të ndaluar me ligj për fëmijët, të cilët, sipas tij, më pastaj po përfundojnë si delikuent nëpër burgje dhe qendra korrektuese. Shala tha se gjendja e fëmijëve në Kosovë nuk është e mirë, Kosova e ka një përqindje të madhe të



të rinjve, dhe shteti mund të ndërtohet mbi ta dhe me ta. “Ju si studentë duhet të shkoni edhe në qendrën korrektuese në Lipjan t’i shihni se në çfarë gjendje janë të miturit. Nuk mund ta keni të qartë situatën vetëm duke e lexuar ligjin, i cili është i shkruar për mrekulli, por thjesht shikoni ato dokumente në fillim dhe vetë e shihni se sa zbatohen në praktikë në vendin tonë”, tha Shala.

Adile Shaqiri, nga Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes në Ministrinë e Punës (MPMS), foli në përpikëri për punën që bëhet në këtë ministri rreth të drejtave të fëmijëve në Kosovë. Ajo tha Ministria në fokus ka fëmijët viktimë, dhe mbrojtjen e fëmijëve të braktisur me fëmijët pa përkuajdesje prindërore, me

fëmijët që punojnë punë të rënda etj. Shaqiri po ashtu foli për sfidat, për shpenzimet buxhetore të kësaj ministrie në përmbushjen e detyrimeve për të drejtat e fëmijëve në nevojë sociale.

Ndërsa, profesoresha Merita Shala, se nëse investohet një dollar në fëmijë në cilindo program cilësor, ky fëmijë kur të bëhet i rritur shoqëria fiton 17 dollarë. Po ashtu nëse në fëmijëri bëhet një shkollim cilësor, më nuk do të ketë sjellje delikuede. Vetëm 3% të fëmijëve në Kosovë marrin edukim të hershëm, kurse 97% nuk kanë edukim të hershëm, theksoi ajo.

Në debat morën pjesë edhe shumë studentë të Fakultetit Juridik dhe stafi akademik, të cilët diskutuan dhe dhanë vlerësime të ndryshme, mbi temën e debatuar.

## Përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane vizituan Fakultetin e Anglishtes



Dekanja e Fakultetit të Anglishtes, Venera Lllunji priti në një takim përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane, të cilët merren me fushën e

arsimit, z. George Chinnery, z. Kanishka Gangopadhyay dhe znj. Remzije Potoku. Gjatë takimit u bisedua për vazhdimin e projektit të

filluar nga viti i kaluar, ku në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane ishte angazhuar prof. dr. Ann Snow, eksperte në fushën e Gjuhës Angleze për të bërë një vështrim studimor dhe vlerësim të Fakultetit të Anglishtes, me qëllim të ofrimit të përkrahjes në procesin e trajnimit të mësimeve në këtë fakultet. Trajnimet e planifikuara do të fillojnë të mbahen më 9 qershor deri me 12 qershor 2015 dhe të gjithë mësuesit në Fakultetin e Anglishtes janë të obliguar të marrin pjesë. Ambasada amerikane ka dhuruar 25 libra për profe-

sorët të cilët do të jenë pjesë e këtij trajnimit. Trajnimi do të mbahet në formë të seminareve të punës (workshop).

Përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane vizituan edhe bibliotekën e fakultetit për të parë nëse i plotëson biblioteka nevojat e studentëve dhe mësimeve për një proces të mbarë pune. Të dy palët u pajtuan që Ambasada mund të ofrojë përkrahje të herë pas herë me revistat të ndryshme të cilat mbulojnë fushën e arsimit dhe mësimeve në gjuhën angleze.

Çështja tjetër që u bisedua

ishte edhe mundësia dhe përkrahja që duhet ta kenë mësuesit në procesin e zhvillimit të tyre akademik dhe profesional kur merret parasysh që përgatitja e një mësuesi reflekton edhe në përgatitjen e studentit.

Të dy palët u pajtuan që bashkëpunimi ndërmjet Kolegjit AAB, respektivisht ndërmjet Fakultetit të Anglishtes dhe Ambasadës Amerikane të vazhdojë me një qasje dhe frymë pozitive dhe për të mirën e studentëve dhe mësimeve.

“Ditët e AAB-së, 2015”

## Hiking në Bjeshkët e Sharrit

Në kuadër të Manifestimit Tradicional “Ditët e AAB –së 2015”, studentët e Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit vizituan Liqenin e Akullit të Lubotenit. Në aktivitet ishin pjesëmarrës mbi 50 studentë e profesorë të AAB-së.

Gjatë udhëtimit deri në destinacion studentët patën mundësinë të shijojnë bukuritë piktoreske të Bjeshkëve të Sharrit, si dhe të përjetojnë përvoja të paharrueshme.



## Studentët e Juridikut në Gjakovë, simuluan shikimin e vendit të ngjarjes

Në kuadër të Manifestimit Tradicional “Ditët e AAB –së 2015”, Fakulteti Juridik, dega në Gjakovë, së bashku me studentët e vitit të dytë dhe të tretë, organizuan aktivitetin e simuluar “Shikimi në vendin e ngjarjes- vrasje e rëndë”. Më konkretisht gjatë këtij aktiviteti studentët janë njoftuar për rolin e policisë, prokurorisë dhe gjykatës gjatë shikimit dhe mbledhjeve të provave në vendin e ngjarjes.

Studentët paraprakisht kanë mbajtur një videokonferencë se si bëhet shikimi i vendit të ngjarjes dhe si raportohet



në medie.

Me këtë aktivitet studentët patën rastin nga afër të aplikojnë praktikisht në

hapësirë të hapur shikimi e vendit të ngjarjes sipas procedurave hetimore kriminalistike.

## 30 mësimdhënës të AAB-së ndoqën trajnimin “Metodologjia e mësimdhënies”, i mbështetur nga Ambasada Amerikane në Kosovë

I mbështetur dhe në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane në Prishtinë, Fakulteti i Gjuhës Angleze, gjatë këtyre ditëve mbajti një trajnim katër ditor për stafin akademik të AAB-së. Temë kryesore e trajnimit ishte “Metodologjia e mësimdhënies”, ku u përfshinë strategjitë dhe teknikat e mësimdhënies, stilet e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Trajnimin e udhëhoqi ekspertja e arsimit Dr. Ann Snow.

Qëllimete trajnimit ishin të reflektohet në qasjet më të reja të mësimdhënies dhe mësimnxënies, si të ruhet bilanci mes teorisë dhe praktikës, si t’u ofrohet studentëve ndihma në gjetje të literaturës dhe resurseve të tjera të informimit me qëllim të krijimit të një niveli të dobishëm të njohurive gjatë studimeve, të cilin ata më pas do ta aplikojnë qoftë në vendin e tyre të punës apo në studime të mëtejme

shkencore. Qasja interaktive në procesin e mësimdhënies ishte po ashtu një nga temat kryesore të këtij trajnimit.

Qatip Arifi, mësimdhënës dhe pjesëmarrës në këtë trajnim, tha se aftësitë që janë fituar nga ky trajnim janë aplikueshmëria e mësimdhënies dhe mësimnxënies. “Unë mendoj që është një problem i veçantë në Kosovë, sepse sistemi edukativ nuk ka ndryshuar shumë me të përparshmin, e neve na duhen shumë më tepër njohuri ngabotamod-erne se si duhet të ecim me kohë dhe të jemi më të frytshëm edhe në mësimdhënie edhe në mësimnxënie.

“Gjatë trajnimit arritëm të kuptojmë se qasja CLT i jep prioritet përmbajtjes semantike në mësimin e gjuhës. Kjo do të thotë se nxënësit mësojnë formulimin gramatikor përmes kuptimit e jo anasjelltas. Dr. Snow vuri theksin mbi planin aktiv që ne si profesorë duhet



ta zhvillojmë, dhe insistoi që secili nga ne të aplikojë të paktën disa nga strategjitë dhe stilet që ofron kjo qasje në menaxhimin e klasave të mëdha të studentëve”, ka thënë Elisa Nikolla, mësim-

dhënëse dhe pjesëmarrëse e trajnimit.

Në trajnim morën pjesë afërsisht 30 mësimdhënës të fakultetit në fjalë, të cilët në fund të trajnimit morën edhe nga një certifikatë për

pjesëmarrjen e tyre aktive dhe kontributin e dhënë gjatë gjithë kohës.

Trajnimi është mbajtur në ambientet e AAB-së në Prishtinë.

“Ditët e AAB-së, 2015”

# U shpallën fituesit e garës universitare “Shpërblimet për punimin më të mirë të studentit”



Garastudentore për punimin më të mirë, të prezantuar në nivel të fakulteteve, pati nivel tjetër. Përmes një aktiviteti të organizuar në kuadër të manifestimit “Ditët e AAB-së, 2015”, kjo garë sot pati karakter garues, në nivel universitar.

Punimet e përzgjedhura nga komisionet përkatëse të fakulteteve që operojnë në të tre degët e AAB-së, në Prishtinë, Ferizaj e Gjakovë, u prezantuan para komisionit universitar dhe të pranishmëve të tjerë.

Pas prezantimit, me vendim të komisionit përkatës, punimet e prezantuara u

shpërblyen, si vijon:

Shpërblimin për hulumtim, akademizëm dhe prezantim, e ndanë dy punime: Për hulumtim u vlerësua studentja Behare Pllana, nga Fakulteti i Shkencave Sociale, në Prishtinë, për punën e bërë në hulumtimin e saj në temën “Ndikimi i edukimit parashkollor në zhvillimin social të fëmijëve”; Ndërsa me po të njëjtin shpërblim por me vlerësim të theksuar në prezantimin e tij, u shpërblye studenti Eas Hida, nga Fakulteti Juridik në Prishtinë, për temën “Terrorizmi dhe IRA”.

Vlerësimi për relevancë sho-

qërore e ekonomike, i takoi temës “Efekti i shpërndarjeve së buxhetit në zhvillimin ekonomik të Kosovës”, Blina Zhubi dhe EgzonThaqi; Për inovacion dhe ndërveprim i takoi temës “Lexuesi i mendjes”, Shkëlqim Miftari dhe Bujar Prebeza, nga Fakulteti i Shkencave Komputerike, dhe Vlerësimi për angazhim në komunitet i takoi temës “Etika në administratën publike në Ferizaj”, iprezantuar nga Vjollca Aliu, studente e Fakultetit Administratës Publike në Ferizaj.

“E falënderoj Kolegjin AAB që organizon aktivitete të tilla, sepse këto aktivitete ndikojnë direkt në motivimin tonë drejt një rruge më të ndritur. Rinia është e ardhmja e vendit, ne si rini-studentë, jemi duke studiuar dhe punuar në vazhdimësi në ngritjen e mirëqenies së vendit tonë”, tha me këtë rast studentja Blina Zhubi. Në përbërje të komisionit vlerësues ishin: XhavitRexhaj, Fatmir Qollkaj, Kosovare Ukshini, Fortesa Kadriu, DashnimIsmaili, dhe Blerta Prevalla.



## Vizitë në “SOS Fshatin e Fëmijëve”



Në kuadër të Manifestimit “Ditët e AAB-së, 2015”, studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale, programi Përkujdesja dhe Mirëqenia e Fëmijëve, bashkë me Unionine Studentëve të AAB-së, mbajtën aktivitetin humanitar për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve. Studentët e AAB-së përveç vizitës kishin përgatitur edhe punë dore si, lodra, instrumente muzikore dhe piktura, të cilat ua dhuruan fëmijëve të “SOS Fshatit të Fëmijëve”.

Me këtë rast, koordinatoresja e SOS Fshatit të fëmijëve, znj. Nita Luzha u tregoi studentëve të AAB-së se si funksionon ky institucion, si edukohen fëmijët aty, cili është kujdesi i tyre ndaj këtyre fëmijëve.

Po ashtu studentët takuan edhe psikologun, pedagogët dhe punëtorët socialë të cilët shpjeguan për kujdes-

in ndaj fëmijëve në “SOS” si dhe rolin dhe punën e tyre që bëjnë aty.

Në fund të aktivitetit, koordinatoresja Luzha shpreh e kënaqur me këtë bashkëpunim dhe shumë falënderuese për dhuratat të cilat ishin përgatitur nga studentët e AAB-së. Ajo tha se dyert e “SOS Fshatit” do jenë të hapura çdo herë për studentët e AAB-së.

Edhe mësimdhënëset Prof. Alberita Bytyçi dhe prof. Saranda Shatri, u shprehën falënderuese për mikpritjen e ngrohtë dhe për gjitha informacionet që udhëheqësit e “SOS Fshatit të fëmijëve” i ndanë me studentët e AAB-së, ndërsa këta të fundit patën rastin të prezantojnë përgatitjen e tyre profesionale, me ç’ rast dëshmuan se Fakulteti i Shkencave Sociale është duke punuar me përkushtim të madh në përgatitjen e tyre.



Studentët e vitit të tretë të Fakultetit të Shkencave Sociale, kanë përfunduar me sukses demonstrimet e mbajtjes së orës praktike, që i paraprin praktikës profesionale në institucione parashkollore.

Demonstrimi i orës praktike është pjesë e vlerësimit

në kuadër të lëndës “Mësimi Praktik”, përmes së cilës synohet që të përgatiten studentët para realizimit të praktikës profesionale në institucione parashkollore, e që është obligative për studentët e programit Përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve

“Ditët e AAB-së, 2015”

# U mbyll me sukses edicioni i tetë i Manifestimit tradicional “Ditët e AAB-së, 2015”



Në ambientet e institucionit të arsimit të lartë universitar AAB, në Prishtinë, u mbajt ceremonia solemne e mbylljes së manifestimit universitar tradicional, më të madhit në Kosovë dhe rajon, “Ditët e AAB-së, 2015”, ku përveç studentëve e profesorëve të AAB-së, morën pjesë, personalitete nga fusha biznesore, hulumtuese e shkencore në nivel vendi dhe ndërkombëtar, miq dhe partnerë të AAB-së..

Në ceremoninë përmbyllëse, rektori i AAB-së, prof. dr. Lulzim Tafa, falënderoi të gjithë ata që kanë kontribuar rreth këtyre aktiviteteve dhe tha se këto aktivitete ishin më kreativitet që AAB-ja i

ka organizuar deri më tani, duke mos harruar për t’i përmendur organizimet e ndryshme një mujore, si akademike, humanitare, sportive, artistike, etj. Aktivitete e mbajtura në kuadër të Manifestimit “Ditët e AAB-së, 2015”, të organizuara në bashkëpunim të ngushtë me stafin akademik dhe ekspertë të shumtë, kanë pas për qëllim që t’u ofrojnë studentëve dhe pjesëmarrësve të tjerë një program shumë prestigjioz, me organizime të veçanta, si ligjërata të shumta speciale, debate e tryeza, konferenca shkencore, si dhe aktivitete kulturore-artistike, sportive e humanitare.



Me rastin e përmbylljes së suksesshme të Manifestimit “Ditët e AAB-së, 2015”, u ndanë mirënjohje e shpërblime edhe për kompanitë dhe institucionet partnere të AAB-së.

Me këtë rast, drejtori gjeneral i PTK-së, Agron Mustafa, duke shprehur falënderimet e tij për mirënjohjen e ndarë për këtë kompani nga ana e AAB-së, tha se PTK do të vazhdojë të bashkëpunimin me AAB-në, si një institucion prestigjioz i arsimit të lartë, ndërsa studentët i porosi që të punojnë pareshtur për të sendërtuar ëndrrat e tyre me bindjen se kështu mund të jenë në pozitë që i ëndërojnë.

Kurse Ora Bytyçi, drejtore-

shë e SOS Fshatit të Fëmijëve, institucion ky të cilit iu nda mirënjohje për bashkëpunimin me AAB-në, tha se është kënaqësi t’i shohim këto suksese të studentëve të AAB-së. Ajo tha se: “AAB ka një vend të posaçëm në SOS Fshatin e Fëmijëve, pikërisht për shkak se e diplomuara e parë në studime universitare, nga fëmijët e SOS Fshatit, kishte qenë bursiste e AAB-së”. Mirënjohje për bashkëpunim iu nda edhe udhëheqëses së rrjetit të Kopshteve “Bardha” në Prishtinë, dhe Administratës Tatimore të Kosovës, ndërsa një të tillë e pranoi edhe AAB nga Qendra Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut,

për kontributin e studentëve dhe stafit të AAB-së, në aksionin për dhurimin e gjakut.

Një mirënjohje në shenjë falënderimi për bashkëpunim, AAB e ka ndarë edhe për sektorin e Arsimit të Ambasadës Amerikane në Kosovë. Me këtë rast ekspertja amerikane për arsim, Ann Snow, premtoi se Ambasada Amerikane do të vazhdojë të mbështesë AAB-në përmes projekteve të tjera të bashkëpunimit edhe në të ardhmen.

Në ceremoninë përmbyllëse të edicionit të tetë të Manifestimit “Ditët e AAB-së, 2015”, të gjithë studentëve, fitues në garat universitare në aktivitetet e ndryshme akademike, hulumtuese, artistike e sportive, iu ndanë mirënjohje, medalje dhe nga një tablet.

Pjesëmarrësit e ceremonisë patën rastin të ndjekin edhe një recital, nga studentët e Fakultetit të Gjuhës Angleze, dega në Gjakovë, vargje këto të shkruara nga studenti Arjan Ukmeta, dhe të recituar bashkërisht nga Rrezarta Zengeler, Zana Nura dhe Blertha Zharra. Në fund të ceremonisë organizatori i kësaj ceremonie shtroi edhe një koktej rasti.



# Vizitë studimore në institucionet arsimore gjermane



Prej 22- 26 prill 2015 Kolegji AAB organizoi një vizitë studimore në Gjermani me studentët nivelit master në Fakultetin e Shkencave Sociale. Vizita u organizua nga profesori Lulzim Dragidella dhe nga rektorati i AAB në fakultetet e Shkencave të Aplikuara në Universitetin e Heidenheim-it dhe në Universitetin e Nurnbergut. Pos kësaj, 14 studentë dhe dy mësues të tjerë vizituan edhe dy qendra për përkujdesjen e fëmijëve dhe të rinjve në nivel vendor.

Fakulteti i Shkencave Sociale – Universiteti i Shkencave të Aplikuara - Heidenheim Në ditën e parë të vizitës në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Heidenheimit grupi i studentëve tanë kanë këmbëruar përvojat me studentët e Fakultetit simotër në Heidenheim. Profesori J. Falterbaum, udhëheqës i programit të studimeve sociale ka bërë një prezantim të sistemi të mirëqenies sociale në Gjermani, dhe të sistemit dual të studimit në FSHS në Heidenheim.

Pastaj, studentët mikpritës kanë bërë prezantimin e projekteve të tyre në disa tema: mbrojtja e fëmijëve me nevojë të veçanta në Gjermani, papunësia dhe trajtimi i saj në Gjermani, të qenit student në Gjermani, roli, detyrat dhe aktivitetet e unionit studentor në Heidenheim (ASTA, StuPa), Profesori Lulzim Dragidella ka bërë një paraqitje të sistemit të mirëqenies sociale në Kosovë, studenti Besim Alaj ka prezantuar AAB-në dhe studentja Afërdita Hyseni ka folur në përgjithësi për sistemin e mirëqenies sociale në Kosovë nga kënd-

vështrimi i organizatave ndërkombëtare aktive në Kosovë në këtë fushë, si për shembull Amici dei Bambini.

Gjatë pauzës studentët nga dy universitetet kanë shikuar mundësinë e angazhimit të përbashkët në hulumtime të ndryshme në fushat me inter të ndërsjellë, si për shembull papunësia, fëmijët me nevojë të veçanta, mbrojtja sociale, institucionet për mbrojtje sociale e të tjera. Në Fakultetin e Shkencave Sociale kanë premtuar ta shohin mundësinë e vizitës së grupit të studentëve të tyre në AAB për një ditë gjatë qëndrimit të tyre të ardhshëm në Kosovë.

Takimi me udhëheqësen e Zyrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar të Universitetit të Heidenheim-it, profesor Brigitte Ilg Me prorektorën për bashkëpunim ndërkombëtar u trajtuan të gjitha fushat e bashkëpunimit: mobilitetet shumëpalëshe, dypalëshe, projektet e përbashkëta, programet e shkëmbimit të studentëve, puna praktike, internacionalizimin, programet në gjuhën angleze dhe në gjuhët e huaja, programet e studimit, etj. Në fund palët u morën vesh për zhvillimin hap pas hapi të bashkëpunimit sipas fushave të identifikuar prioritare.

Në Universitetin e Heidenheimit është bërë edhe një vizitë e hollësishme e infrastrukturës në ndërtesën e re. Në këtë ndërtesë janë vizituar sallat e mësimit, laboratorët, zyrat, hollet, atriumet dhe pjesë të tjera që do të ishin me rëndësi për ndërtesën e re të AAB-së.

Në klasa ka lënë përshtypja tabela me nivele të ndryshme dhe lëvizje horizontale e vertikale – dërrasë e gjelbërt në të cilën shkruhet me shkumës, tabelat smart, ndriçimi në klasa, projektori vizual (një formë e projektorit klasik që nuk përdorë transparenca por çfarëdo materiali), përdorimi i tabelave të ndryshme me tapë, të polivinilit, të plastikës, me letër, e të tjera.

Përdorimi i sensorëve për ndezje dhe ndërprerje të ndriçimit nëpër klasa, përdorimi i një çelësi për të gjitha dhomat, përdorimi i kartelës për hapje të derës në laboratorin e informatikës, salla e provimeve me 72 ulëse, shkallët flutur me dy drejtime, etj. Janë disa nga inovacionet e përdorura në këtë universitet që mund të hyjnë në punë në

zanate. Drejtoresha e Departamentit për Fëmijë dhe të Rinj, znj. Gabrielle Wiedemann ka bërë prezantimin e programit të punës me fëmijët dhe të rinjtë si në aspektin akademik dhe në atë të aftësimit për punë dhe jetë. Vizitorët nga AAB panë objektin e Qendrës, shërbimet dhe mbajtën një diskutim të gjatë e të pasur për përvojat dhe praktikën e mira në të dyja vendet.

Rezultatet konkrete të vizitës:

Në Universitetin Heidenheim është vendosur që të fillojë mobiliteti i studentëve të AAB-së për tetorin e këtij viti për programet e studimit në gjuhën angleze në fushën e ekonomisë.

Në EVA Heidenheim – Qendër për Përkujdesje të Fëmijëve është premtuar

i planeve individuale, konsultime në qendër e të tjera. Pjesë e Kishës Evangjeliste, kjo qendër ofron shërbime për qytetin e Nurnbergut për personat në nevojë për përkujdesje sociale e psikiatrike.

Znj. Wiebke Majoor nga kjo qendër ka ofruar të informacione për punën e qendrës dhe format e bashkëpunimit të kësaj qendre me administratën e qytetit të Nurnbergut. Studentët e AAB pastaj prezantuan përvojat e Kosovës dhe bënë pyetje lidhur me sistemin gjerman të përkujdesjes. Në fund, mysafirët nga Kosova kanë vizituar objektin e Qendrës. Në fund u vendos që të vendoset bashkëpunimi në shkëmbimin e përvojave në mes të dy institucioneve.

Në seancat e pasdites, studentët vizituan Fakultetin



ndërtesën e re të AAB-së që pritet të hapet në tetor të këtij viti.

EVA Heidenheim – Qendër për Përkujdesje të Fëmijëve me probleme sociale në Heidenheim

Kjo Qendër përkujdeset për rreth 150 fëmijë të moshave deri në 16 vjet të cilët kanë problem të sjelljes ose problem të tjera sociale. Qëndrimi në këtë qendër është konviktor dhe ofrohen të gjitha shërbimet prej vendosjes, ushqimit, shkollimit, trajtimit të problemeve e të tjera. Fëmijët e vendosur këtu kanë mundësi të përfitojnë edhe nga kurset më të ndryshme dhe aftësim për

një vend për punë praktike të studentëve në kohëzgjatje një deri gjashtë muaj duke filluar nga viti 2015.

Në mëngjesin e datës 24 prill grupi i studentëve të AAB-së kanë vizituar Qendrën tjetër për përkujdesje Betreutes Wohnen për personat me probleme mendore e sociale. Për dallim nga EVA Heidenheim, kjo Qendër merret me shumë me konsultime, terapi psikologjike dhe ndihmë jokonviktores personave në nevojë. Shërbimet që ofrojnë këta janë: konsultime 24 orë në telefon, vizita në banesë të klientëve, programi për trajtimin e personave në ndihmë, hartimi

e Shkencave Sociale të Universitetit të Nurnbergut ku u priten nga profesoresha Gertraude Mueller, profesoreshë në këtë fakultet. Profesoresha Mueller i prezantoi programet e fakultetit për nivelet bachelor dhe master si dhe sistemin dual të studimeve sociale në këtë fakultet. Në prezantimin e vet, prof. Mueller tregoi se për implementimin e sistemit dual të studimeve rëndësi prioritare ka lidhja dhe mirëmbajtja e partneriteteve me partnerët social. Në fund të takimit grupet u dakorduan që të vazhdojnë praktika e shkëmbimit të vizitave në mes të dy universiteteve.

# Studentët e AAB-së në Panairin e Parë Ndërkombëtar “HI-TECH SHOW”



Mbi 60 studentë të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike në AAB, në koordinim me disa nga anëtarët e stafit akademik si, Ermir Rogova, Fatime Gashi, Krenar Kepuska, Shpend Lutfiu dhe Valdete Daku, gjatë këtyre ditëve vizituan Panairin e Parë Ndërkombëtar “HI-TECH SHOW”, në Tiranë.

“Studentët nga afër patën mundësi të shohin arritjet më të fundit teknologjike, duke

qartësuar më shumë edhe për vete, profesionin e tyre që e kanë përzgjedhur dhe mundësitë e zhvillimit të tyre profesional”, ka thënë mësimdhënësjë Fatime Gashi.

Gjatë vizitës në këtë panair, studentët patën mundësi të shohin prezantimin e një printeri tre-dimensional (3D), avion ultra-light, megamonitor me LED, pajisje për fikjen e zjarrit, lajmërimi në krimit me telefon

etj. Kurse nga sektori i komunikacionit ka pasur aplikacione për formën elektronike të gjobave me informata të detajizuara, si dhe sektorin e shitjeve ku ishin prezantuar produkte të markave të ndryshme si laptopë, USB, e produkte të tjera. Përveç panairit studentët vizituan edhe “Muzeun Kombëtar”, dhe monumente të tjera historike në Tiranë.

## U mbajt tryeza “Ndikimi i edukimit parashkollor në zhvillimin e personalitetit të fëmijëve”

Fakulteti i Shkencave Sociale i Kolegji AAB, organizoi një tryezë diskutimi me temën: “Ndikimi i edukimit parashkollor në zhvillimin e personalitetit të fëmijëve”, ku të pranishëm përveç stafit akademik ishin edhe studentët e po këtij fakulteti.

Me këtë rast, udhëheqësja e këtij fakulteti, prof. Elizabeta Musliu pasi përshëndeti të pranishmit, foli për rëndësinë e diskutimit dhe temën e debatit. Xhevahire Balaj nga “Trauma Center, Diakonie Kosova”, nën fasilitimin e prof. Fortesa Kadriu, shtjelloi rëndësinë e edukimit parashkollor në zhvillimin social dhe emo-

cional të fëmijës, duke theksuar rëndësinë e edukatorëve për të shërbyer si model për lidhjen me fëmijën. Ndërkaq, Ajete Kërçeli (PEN) diskutoi çështje të zhvillimit të roleve dhe stereotipeve gjinore, duke i vënë theks ndikimit të tyre në zhvillimin e karrierës më vonë. Kurse Blerina Halilaj dhe Sherife Balaj prezantuan kopshtet “KidsAcademy” dhe “Ama”, dhe prezantuan programin “Montessori” dhe format e disiplinimit pozitiv duke dhënë sugjerime praktike për studentë.

Në fund studentët u shprehën shumë të kënaqur dhe patën rastin të debatojnë direkt me panelistët.



### “Ditët e AAB-së, 2015”

## Debat në temën “Rehabilitimi dhe risocializimi i personave të dënuar dhe integrimi i tyre në shoqëri”

Në kuadër të Manifestimit Tradicional “Ditët e AAB – së 2015” Fakulteti Juridike, dega në Ferizaj, organizoi tryeze me temën “Rehabilitimi dhe risocializimi i personave të dënuar dhe integrimi i tyre në shoqëri”, pjesë e projektit kërkimor me të njëjtin titull, të përkrahur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).

Ne debat lidhur me këtë temë të projektit kërkimor morën pjesë profesor, asistent, studentë, përfaqësues të organeve shtetërore si Gjykata, Prokuroria, Polica,

të institucioneve penitensiare dhe të tjerë, të cilët e vlerësuan punën kërkimore lidhur me këtë temë dhe paraqiten një varg sugjerimesh dhe propozimesh.

Marrë në tërësi tryeza dhe debati u vlerësuan të suksesshëm ngase tema risocializimi dhe rehabilitimi i të dënuarve ishte e qëlluar dhe me interes e veçante parandalimin e kriminalitetit në vend.

Është e njohur se në penologjinë bashkëkohore dhe në sistemin penitensiar aktual si qëllim kryesor i sanksioneve penale e veçmas

dënimin me burgim është deklaruar risocializimi, rehabilitimi, dhe riintegrimi i të dënuarve në shoqëri pas mbajtjes – vuajtjes së dënimin me burgim. Në këtë drejtim institucionet korrektuese – përmirësuese dhe edukativo – përmirësuese kanë një përgjithësi të veçantë në realizimin e këtij qëllimi. Projekti kërkimor në fjalë dhe diskutimet e zhvilluara gjatë tryezës edhe njëherë theksuan rolin vendimtar të institucioneve të tilla në realizimin e këtyre qëllimeve.



“Ditët e AAB-së, 2015”

# AAB nderoi me Çmimin “Ali Podrimja”, shkrimtarin malazez Jevrem Bërkoviq



Në një ceremoni solemne, ku morën pjesë krerët më të lartë të institucioneve të Kosovës dhe përfaqësues të shumtë të korit diplomatik në Kosovë si dhe figura me rëndësi të jetës publike të Malit të Zi, Kolegji AAB ka nderuar me Çmimin më të

lartë për letërsi, shkrimtarin malazez, mikun e madh të shqiptarëve dhe të Kosovës, Jevrem Bërkoviq.

Duke u përkulur para fotografisë së poetit më të shquar kosovar, Ali Podrimjes, emrin e të cilit e mban Çmimi më i lartë për letërsi

i Kolegjit AAB, shkrimtari malazez Jevrem Bërkoviq, ka emocionuar të gjithë të pranishmit deri sa e ka pranuar këtë çmim nga rektori i AAB-së, Lulzim Tafa.

“Jevrem Bërkoviqin, mikun e madh të shqiptarëve dhe të Kosovës, e njoh përmes poezive të tij, por edhe për zërin e tij kritik për çështjet e rajonit. Jam i bindur se edhe vet Ali Podrimja do të ishte i lumtur në amshim pasi që me çmimin që mban emrin e tij, po nderohet shkrimtari i madh nga Mali i Zi, Jevrem Bërkoviq”, tha me këtë rast rektori Lulzim Tafa.

Ndërsa, kryetari i jurisë për ndarjen e Çmimit “Ali Podrimja”, prof. dr. Agim Vinca, tha se Bërkoviq e meriton këtë çmim pasi që është njëri nga krijuesit më të mëdhenj të kohës së ish-Jugosllavisë dhe i gjithë rajonit. “Një arsye tjetër pse iu nda ky çmim këtij poeti është se Jevrem Bërkoviq me Ali Podrimjen ishin shokë të vjetër dhe kishin marrëdhënie shumë të mira miqësore në mes vetë”, theksoi Vinca.

Nësolemnitetin e organizuar me këtë rast, ku u shënuar edhe Dita e Pavarësisë së Malit të Zi, nga komuniteti

malazez në Kosovë, një fjalë rasti e mbajti edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Kadri Veseli, i cili tha se çmon lartë veprimtarinë dhe kontributin e shkrimtarit malazez, Jevrem Bërkoviq, për zërin e tij kritik për çështjet rajonale. Kryetari Veseli, foli edhe marrëdhëniet mes dy shteteve fqinje, si dhe për rëndësinë që kishte pavarësia e Malit të Zi në vitin 2006 për procesin e pavarësisë së Kosovës: “Ne jemi të lumtur që Prishtina dhe Podgorica ndajnë të njëjtat pikëpamje mbi nevojat aktuale të rajonit dhe të ardhmen e tij. Mbi këtë bazë, të dy vendet tona janë duke zhvilluar marrëdhënie shumë të mira në të gjitha fushat e interesit të përbashkët”, tha ndër të tjera kryetari Veseli.

Laureati i Çmimit “Ali Podrimja” 2015, Jevrem Bërkoviq, në fjalimin e tij tha se kjo ditë është madhështore për të, por, njëkohësisht edhe e dhimbshme që nuk e ka pranë mikun e tij të ngushtë, Ali Podrimjen. Ai thuajse tërë fjalimin e tij ia kushtoi Ali Podrimjes, duke treguar për miqësinë dhe lidhjen që kishin së bashku, duke e përmendur

edhe ëndrrën që e kishin për pavarësinë të këtyre dy shteteve: “Me vëllamin Ali Podrimja, kemi ëndërruar dhe ëndërronim me verë e pa verë se do të vinte dita kur Mali i Zi dhe Kosova të ishin të pavarura. - Më në fund edhe Kosova jote e fitoi shtetësinë dhe njihet ndërkombëtarisht”, iu drejtua Podrimjes. “Atëherë unë premtoja se ne malazezët do të ishim të parët që do e prananim Kosovën e pavarur, dhe qemë ndër të parët”, theksoi Bërkoviq.

Ai përmendi edhe dy rastet e atentateve të pasuksesshme ndaj tij, pikërisht për shkak të qëndrimit të tij ndaj shqiptarëve dhe Kosovës.

Organizimin e ka përshëndetur edhe ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, i cili tha se rrënjët e miqësisë në mes malazezëve dhe popullit të Kosovës janë shumë të thella.

Organizatorët e kësaj ceremonie ishin: Kolegji AAB, Shoqata e Malazezëve të Kosovës, Ambasada Norvegjeze në Kosovë dhe Instituti Ndërkombëtarë Malazez për Shtyp në Nikshiq.

## Doli libri më i ri shkencor “Komunikimi në diplomacinë publike”, i autorit Hasan Saliu, botim i AAB-së Imazhi i Kosovës në një studim 370 faqesh

*Libri i cili flet për imazhin ndërkombëtar të Kosovës, me parathënie të Artan Fugës, ka gjithsej 374 faqe dhe gjendet edhe në libraritë e Prishtinës dhe Tiranës.*

Doli nga shtypi libri më i ri shkencor “Komunikimi në diplomacinë publike-Soft power-i dhe imazhi ndërkombëtar i Kosovës”, me parathënie nga Artan Fuga, e studiuesit të komunikimeve dhe mediave Hasan Saliu. Libri është një studim më shumë se trevjeçar, i mbrojtur në vitin 2013 në Shkollën e Doktorale të Departamentit të Gazetarisë dhe të Komunikimit dhe Informacionit në Universitetin e Tiranës, e drejtuar nga prof. dr. Artan Fuga (akademik), i cili ka hapur për herë të parë kërkimet e thelluara në komunikime dhe studime mbi mediat.

Akademik Fuga në parathënie të këtij libri thotë se

autori i këtij libri, dr. Hasan Saliu, ka meritën se është i pari që e ka aplikuar në një studim tërësor në botën shqiptare, në librin shqip, me sukses të plotë, dhe duhet të shërbejë për të bërë të ndjeshëm qytetarin, vendimmarrësit, politikanët, se një opinion pozitiv të popujt e tjerë ndaj aksioneve dhe qenies të një populli, është një faktor i madh lehtësues i realizimit të strategjisë së tij. Dr. Fuga shton se autori ka punuar disa vite rresht për ta nxjerrë këtë libër që lexohet ndoshta për disa orë, aq i qartë dhe i strukturuar mirë që është.

Ndërsa, autori thotë se ky libër shkencor sjell disa risi. Risia e parë është vetë punimi si risi, sepse deri më tani

nuk ka pasur një studim të veçantë në gjuhën shqipe për diplomacinë publike, pra komunikim me publikët e jashtëm dhe imazhin ndërkombëtar të një vendi dhe shumë risi tjera që autori i ka paraqitur në hyrjen e librit...

Në përgjithësi ky libër shkencor, ngërthen trajtimin e një sistemi të ndërlikuar ku marrin pjesë aktorë të ndryshëm shtetërorë dhe joshetërorë, të cilët komunikojnë me publikët e huaj, me qëllim që t'i informojnë dhe ndikojnë ata.

Në tërësi libri është i organizuar në tri pjesë të ndarë me kapituj. Pjesa e parë përshin koncepte teorike, pjesa e dytë diplomacia publike në Kosovë, dhe e treta: mod-

ele krahasuese : praktikuesit e mëdhenj të diplomacisë publike dhe vendet e rajonit. Libri në fjalë gjendet edhe në Bibliotekën e AAB-së, e cila do të jenë në dispozicion të studentëve dhe stafit të këtij institucioni, për qasje sa më të thellë në botën e shkencës e hulumtimit profesional.

Hasan Saliu përveç që është dekan dhe profesor në Fakultetin e Komunikimit Masiv në AAB, është ligjërues edhe në Universitetin publik të Tiranës – studimet master në komunikime. Ai ka qenë organizator dhe bashkorganizator i disa konferencave shkencore për mediat dhe komunikimet, anëtar i bordeve shkencore në disa konferenca, dhe deri më tani ka botuar 15

punime shkencore në revista shkencore shqiptare dhe ndërkombëtare në fushën e komunikimeve masive dhe medieve.



## Studentët e Arkitekturës përfunduan me sukses workshopin në Austri

Studentët e Fakultetit të Arkitekturës për shtatë ditë me radhë, qëndruan në Vjenë të Austrisë, në kuadër të workshopit të organizuar nga TU Wien, me temën: “Cross Border Cooperation”.

Krahas Vjenës, punimet e workshopit u zhvilluan edhe në Bratislavë të Sllovakisë. Studentët e AAB-së punuan

të ndarë në grupe me studentët e Universitetit Teknik të Vjenës dhe universiteteve të tjera pjesëmarrëse në projektin në fjalë.

Punimet e kësaj punëtorie u zhvilluan në ambiente të ndryshme të kampusit të Universitetit Teknik të Vjenës, si: “Seminar Room Argentinierstrasse”, “Mobiles Stadtlabor”, “Seminar Room

260/5”, “Seminar Room 101A, Freihaus”.

Studentët e Fakultetit të Arkitekturës të AAB-së, Rinor Koca, Yllka Qarri, Feriz Kadriu, Blerina Hashani dhe Rina Kastrati prezantuan punën e tyre me shumë sukses në ditën e fundit të këtij workshopi shtatë ditor.

## Doli nga shtypi numri më i ri i Revistës Shkencore Ndërkombëtare THESIS

Doli nga shtypi numri më i ri i revistës kërkimore-ndërkombëtare THESIS, me ISSN dhe Bord Ndërkombëtar, të cilën e boton dy herë brenda vitit Institucioni i arsimit universitar AAB. Në këtë numër mund të lexoni studime dhe punime shkencore e profesionale të rëndësishme nga

fusha e gjuhësisë, e komunikimeve, e ekonomisë, e psikologjisë, e arkitekturës etj., të autorëve vendorë dhe të huaj.

Numrin e ri të revistës mund ta merrni në bibliotekën dhe librarinë e AAB-së, dhe mund ta shfletoni gjithashtu edhe në uebfaqen zyrtare të institucionit tonë.



## Studenti i AAB-së themelues i “Cricket Music”, një prej studiove më të suksesshme muzikore në vend

Donat Prelvukaj, është student i vitit të dytë në Fakultetin e Komunikimit Masiv, drejtimi Produksion, në AAB, por njëkohësisht ka themeluar dhe e menaxhon studion e produksionit “CricketMusic”.

Donati për gazetën “STUDENTI” ka thënë: “Kam punuar dhe vazhdoj të punoj me artistë të ndryshëm dhe të njohur në skenën e muzikës shqiptare si Lyrical Son, Capital T, 2po2, ETNON, Majkin, Ghetto Geasy, Fjolla Morina, por edhe me shumë artistë të tjerë të rinj që pritet të dalin në këtë skenë.

Donati, gjithashtu merret edhe me krijimin e videove të ndryshme muzikore, duke praktikuar konkretisht studimet e tij në drejtimin Produksion në AAB.

“Në AAB më së shumti më bëjnë përshtypje afërsia e ligjëruesve dhe lloj-llo-

jshmëria e tyre në kuadrin profesional, ku shumica nga ta janë fytyra publike, nga të cilët kemi dhe vazhdojmë të marrim shumë mësim dhe përvoja të mira në fushën e produksionit dhe mediave”, përfundoi ai.

Studio “Cricket Music”, është studioja ndër më profesionale muzikore, ku përveç shërbimeve teknike si incizimet, miksime dhe masterizimet e këngëve, ofron edhe shërbime për pjesën kreative në krijimin e këngëve.



## Premierë: “La Bohème”, film dokumentar nga studentët e Komunikimit Masiv, kushtuar veprës së aktorit të madh Faruk Begolli

Në një ceremoni solemne të organizuar mbrëmë në ambientet e Kolegjit AAB, u shfaqet premiera e filmit dokumentar “La Bohème”, kushtuar jetës dhe veprës së aktorit të madh, Faruk Begolli, të punuar nga studentët e vitit të tretë, të Fakultetit Komunikim Masiv dhe Gazetari, drejtimi Produksion, në kuadër të lëndës “Dokumentar televiziv”, të mesimdhënësja Burbuqe Berisha.

Filmi “La Bohème” është punuar në formën narrative, të kombinuar me materiale arkivore, ndërsa janë intervistuar edhe familjarë, shokë, ish-studentë të aktorit, ku në mënyrë kronologjike tregohet jeta dhe vepra e prof. Faruk Begollit në rrafshin personal dhe profesional.

e Begollit.

Rektori i Kolegjit AAB, prof. dr. Lulzim Tafa duke e vlerësuar lart punën e studentëve dhe të mesimdhënësës Burbuqe Berisha, tha se për jetën e Faruk Begollit më shumë flet vet dokumentari i punuar me një vullnet të madh nga studentët.

Ndërsa mesimdhënësja Burbuqe Berisha, tha se “La Bohème” nuk është dokumentari i vetëm që e kanë punuar studentët, ka një numër të madh punimesh e që ia vlejné, ku trajtohen tema kryesisht intriguese për shoqërinë tonë në zhvillim: “Është një brez i ri i studentëve që me të vërtetë kanë shumë zgjuarsiri të prodhojnë filma dokumentarë. Kjo është një rezultat i mirë, që deri vonë nga mundësit e mira që krijon Kolegji AAB për studentët, duke ofruar të gjitha kushte për prodhimin e filmave”.

Pas shfaqjes së dokumenta-

rit, e motra, Asliha Begolliu u shpreh shumë e kënaqur me dokumentarin, ndërsa përgëzoi studentët për punën e bërë, duke i uruar ata edhe për realizime të tjera. Ajo falënderoi Kolegjin AAB dhe profesoreshën Burbuqe Berisha, për inkurajimin e studentëve deri në realizimin e dokumentarit.

Edhe autorët e dokumentarit u shprehën tejet të lumtur që patën rastin ta shfaqin punën e tyre në ekran të madh dhe në prezencë të një audience të tillë: “Kur kemi filluar me punë për dokumentarin për Faruk Begollin, kishim aq shumë material, sa që mendonim se nuk do të kemi mundësi ta përmbledhim, por me ndihmën e Kolegjit AAB, me ndihmën e profesoreshës Burbuqe, me ndihmën e familjes dhe me ndihmën e të gjithë atyre që i kemi intervistuar kemi arritë ta përmbledhim sadopak veprimtarinë e tij”,



tha studenti Gent Jetullahu, skenarist dhe regjisor i dokumentarit.

Në realizimin e dokumentarit “La Bohème”, u angazhuan këta studentë:

3. Producentë: Valdrin Fetahu, Gent Jetullahu
4. Regjia – Gent Jetullahu
5. Skenari: Valdrin Fetahu, Gent Jetullahu
6. Montazhi: Liridon Zejnullahu
7. Ass.Kamere&Udhëheqës teknik: Isa Bajrami
8. Zërimi: Egzon Surkishi

Të gjithë studentët e përmendur e falënderuan Kolegjin AAB, që u ka dhënë mundësinë dhe kushtet nga më të mirat, pastaj stafin e përzgjedhur akademik, dhe profesoreshën e tyre Burbuqe Berisha.

Dokumentari “La Bohème”, kushtuar jetës dhe veprës së aktorit të madh shqiptar Faruk Begollit, mbështetet nga Kolegji AAB, dhe u shfaq në kundër të Manifestimit “Ditët e AAB-së, 2015”.

# AAB priti fituesen e medaljes olimpike Nora Gjakova

Kolegji AAB organizoi konferencë për shtyp me rastin e fitores së medaljes së bronzit të studentes së këtij kolegji, Nora Gjakova në Lojërat Olimpikë Evropiane në Baku. Në këtë konferencë ishin pjesëmarrës edhe trajneri i Nora Gjakovës, Driton Kuka, Majlinda Kelmendi e cila u shpall kampione e botës në xhudo për vitin 2014, presidenti i Komitetit Olimpik, Besim Hasani, prorektori për Çështje Mësimore në AAB, z. Shemsedin Vehapi, përfaqësuesi nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës, Iber Alaj, si dhe studentë dhe profesor të po të këtij kolegji dhe mysafir të tjerë të ftuar. Në këtë konferencë për media, Nora Gjakova u shpreh se ishte shumë e kënaqur me suksesin e arritur dhe tregoi motivin dhe qëllimin e saj për medalje: “Me këtë medalje desha t’i tregoj botës se edhe ne jemi të njëjtë (barabartë)”. Ajo u shpreh se kjo sfidë nuk ishte e lehtë, por falë vetëbesimit dhe falë trajnerit të saj Driton Kuka, i cili kishte punuar jashtëzakonisht shumë me të, arriti deri te ky sukses. Majlinda Kelmendi, e cila po ashtu ishte pjesëmarrëse në këtë konferencë, tha se ndjehet shumë e lumtur që Nora arriti deri te medalja

evropiane, dhe u shpreh se ishte jashtëzakonisht sfidë e madhe ku në një moment kishte menduar se është më e lehtë të jesh garues se sa shikues. Ajo u shpreh se me gjithë problemin që kishte Nora, si të gjithë sportistët në Kosovë që kanë problem me vetëbesimin, tha se ajo mund të shkojë shumë larg në këtë sport. Prorektori i AAB, Shemsedin Vehapi u shpreh jashtëzakonisht i kënaqur që së pari këto dyja sportiste ishin studente të Kolegjit AAB, të cilat sot janë në listat e kampioneve botërorë të xhudos. Ai në emër të AAB-ës i uroi Nora Gjakovës fitoren dhe u

shpreh se ky është një moment historik për Kosovën dhe njëkohësisht për AAB-në, ku fituesit e medaljeve kanë dalë nga po ky institucion. “Janë të rralla universitetet që sjellin kampione, ndërsa AAB-ja do të vazhdojë t’i mbështes këta sportistë, që përvojnë e tyre t’i gërshetojnë edhe në vendet tjera të botës”, theksoi Vehapi. Ndërkaq, drejtori i Komitetit Olimpik, z. Besim Hasani u shpreh se ishte jashtëzakonisht i kënaqur që Kosova ishte pjesëmarrëse për herë të parë si një shtet i pavarur dhe sovran.



## U mbajtën finalët në garat sportive të “Ditëve të AAB-së, 2015”

Në kuadër të Manifestimit “Ditët e AAB-së, 2015”, gjatë ditës së sotme Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit organizoi garat finale në këto disiplina sportive si në: futboll, street- ball dhe ping-pong. Ndeshja finale në turneun në futboll të vogël, u zhvil-

lua në mes të studentëve të Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Fakultetit të Gjuhës Angleze, ku ngadhënjyen studentët e vitit të parë të Fakultetit të Kulturës Fizike. Në finale referoi studenti Ferid Ibishi. Finalja në streetball, u zhvillua në mes të ekipeve

Mickonjat”, nga Fakulteti i Kulturës Fizike, dhe “White-hot”. Fitues u shpall ekipi “Mickonjat” ndërsa në finale referoi profesori Fatmir Pireva. Ndërsa fitues në turneun në pingpong, doli Arlind Haliti, i cili mundi kundërshtarin e tij, Arbër Geci. Refer në

këtë finale ishte prof. Besim Gashi. Koordinator dhe udhëheqës i këtyre aktiviteteve sportive ka qenë prodekani Zenel Metaj. Medaljet dhe kupat për fituesit e vendeve të para, do të ndahen në ceremoninë përmbyllëse të manifestimit

“Ditët e AAB-së, 2015”, më 12 qershor 2015. Të gjithë lojërat u mbajtën në ambientet e Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit, në AAB.





# The British School of Kosova

Shkollë 12 vjeçare, e licensuar nga MASHT



## ATY KU NXENESIT E DUAN MESIMIN

**Niveli parafillor**  
(grup-mosha 5 - 6 vjeç)

**GJIMNAZI**  
**1500 €**  
për vit shkollor

**Niveli fillor**  
Klasa e parë

**Niveli i mesëm i lartë**  
Klasa e dhjetë

**Niveli i mesëm i ulët**  
Klasa e gjashtë

Gjimnazi:  
- shkenca natyrore  
- shkenca shoqërore  
dhe gjuhësore

**12000 €**  
për vit shkollor



Regjistrohu tani

038 556 566

045 575 777

**britishschoolkosova.com**

Magjistrallja Prishtinë - Fushë Kosovë (afër Kolegjit AAB)





**Bleje banesën me këste  
për 3 vite pa kamatë**



**cilësi, lidërsip, sukses!**



# Kolegji AAB

**KONKURS për regjistrim në vitin akademik 2015/2016 në nivelin BA dhe MA**

## EKONOMIK

- BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET
- MARKETING DHE ADMINISTRIM BIZNESI
- MENAXHMENT DHE INFORMATIKË

## SHKENCA KOMPJUTERIKE

- INXHINIERI SOFTUERIKE
- KOMUNIKIMI NË RRJETA
- TELEKOMUNIKIMI DHE TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT (IT)
- MEKATRONIKË

## MENAXHIM SEKTORIAL

- MENAXHIMI I ARSIMIT
- MENAXHIMI I KULTURËS
- MENAXHIMI I SPORTEVE
- MENAXHIMI I SHËNDETËSISË

## JURIDIK

## KRIMINALISTIKË

## INTEGRIME EVROPIANE

## KUJDESI DHE MIRËQENIA E FËMIJËVE

## PSIKOLOGJI

## GJUHË ANGLEZE

## KOMUNIKIM MASIV DHE GAZETARI

- GAZETARI
- PRODUKSION

## ADMINISTRATË PUBLIKE

## SHKENCA POLITIKE DHE DIPLOMACI

## KULTURË FIZIKE DHE SPORT

## ARKITEKTURË

## DIZAJN GRAFIK DHE MULTIMEDIA

## DIZAJN ENTERIERI

## DIZAJN I MODËS

## PIKTURË DHE ARTE VIZUELE

## MUZIKË

AAB ju ofron mundësinë që të studioni në gjuhën angleze në Programet Ndërkombëtare të Universitetit të Londrës

**London School of Economics and Political Science:**  
me programet **Bachelor** dhe  
**Royal Holloway** me programet **Master**

Zona Industriale Prishtinë-Fushë Kosovë,  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës,  
Tel: 038/ 555 444; 038/ 601 019

Mob: 045/ 284 797, 049/ 603 666

Dega në Gjakovë: 045/ 537 337, 045/ 666 551  
Dega në Ferizaj: 0290/ 328 908, 044/ 77 90 90

[info@aab-edu.net](mailto:info@aab-edu.net)

[www.aab-edu.net](http://www.aab-edu.net)

[f /AAB.edu](https://www.facebook.com/AAB.edu)